



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 44

Tiranë – E premte, 29 mars 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 2, datë 27.3.2019	Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja e parë për vitin 2019, grantet “Arsimi bazë”, “Arsimi i mesëm” 3595
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 3, datë 27.3.2019	Për një ndryshim në vendimin nr. 12, datë 16.10.2018, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja II, për vitin 2018, për grantin ‘Arsimi’” 3599
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 284, datë 11.3. 2019	Për procedurën e mbajtjes së aktit të lindjes së fëmijëve, në rastet kur nuk është respektuar afati kohor i regjistrimit të tyre, brenda 60 ditëve nga data e lindjes..... 3600
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 285, datë 11.3.2019	Për krijimin, administrimin dhe përditësimin e regjistrit të përkohshëm për lindjet e raportuara..... 3601
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 286, datë 11.3.2019	Për përcaktimin e procedurës administrative që zbatohet nga zyrat e gjendjes civile kur në aktin e lindjes, mbajtur jashtë Republikës së Shqipërisë, është e paplotësuar rubrika e emrit..... 3604
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 208, datë 15.3.2019	Për miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP) të Qarkut Kukës..... 3607
Urdhër i drejtorit të Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar nr. 74, datë 21.3.2019	Për delegim të përkohshëm të kompetencave..... 3607
Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 50, datë 19.3.2019	Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve për prokurorë të përgjithshëm në Republikën e Shqipërisë” 3608

Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 51, datë 19.3.2019	Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”	3622
Kërkesë e Ministrisë së Brendshme nr. 3484/7, datë 21.3.2019	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës së fshatit Muçaj (Unaza), Bashkia Vorë”	3635
Kërkesë e Ministrisë së Brendshme nr. 4606/5, datë 21.3.2019	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës Marqinet-1 dhe lagjja ‘Llanaj’, Bashkia Vorë”	3635

**VENDIM****Nr. 2, datë 27.3.2019**

**PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT
PËR PROJEKTE TË REJA, THIRRJA E
PARË PËR VITIN 2019, GRANTET
“ARSIMI BAZË”, “ARSIMI I MESËM”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16, dhe të aneksit 3, të ligjit nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja e parë për vitin 2019, për grantet “Arsimi bazë”, “Arsimi i mesëm” pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, me burim financimi buxhetin e projekteve të reja për vitin 2019, nga programet buxhetore “Arsimi bazë” dhe “Arsimi i mesëm”, pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Të gjitha autoritetet kontraktuese, projektet e të cilave miratohen për financim sipas pikës 1, të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të vendimit në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesin në sekretariatit teknik, pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit, si dhe të përdorimit të fondeve dhe emrin e personit përgjegjës për informimin periodik.

3. Autoritetet kontraktuese për projektet, sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të nisin procedurat e prokurimit publik brenda një muaji pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Për fondet e projekteve të pa prokuruar sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtë të rishqyrtojë financimin dhe t'i rishpërndajë ato për një thirrje tjetër/projekte të tjera.

4. Ngarkohet sekretariati teknik, pranë Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, të kryejë monitorimin e ecurisë së projekteve, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 2, të këtij vendimi, dhe të informojë Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe periodikisht Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve, përmes Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. Ngarkohen ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI**Erion Braçe**

Zëvendëskryeministri	zëvendëskryetar;
Ministri i Financave dhe Ekonomisë	anëtar;
Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Brendshëm	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar.



Tabela 1. Lista e projekteve të reja, thirrja e parë për vitin 2019, grantet “Arsimi bazë”, “Arsimi i mesëm”, me cikël zbatimi 2019-2020

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit nga FZHR për vitin 2019 (në lekë)	Vlera e bashkëfinancimit nga NJQV (në lekë)		
					%	Vlera e plotë e bashkëfinancimit (në lekë)	Vlera e bashkëfinancimit për vitin 2019 (në lekë)
		QARKU BERAT					
1	Bashkia Kuçovë	Rikonstruksion i shkollës “18 Tetori”, Kuçovë	76,911,627	21,535,256	30	23,073,488	13,036,744
2	Bashkia Ura Vajgurore	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Azbi Shehu”, Samatice	57,327,077	20,637,748	10	5,732,708	5,732,708
		QARKU DIBËR					
3	Bashkia Klos	Rikonstruksion i shkollës së mesme “Shaban Collaku”	89,342,071	28,142,752	10	8,934,207	8,934,207
		QARKU KUKËS					
4	Bashkia Tropojë	Shkolla Asim Vokshi-Palestër dhe terrene sportive dhe sistemime të jashtme në gjimnazin “Asim Vokshi”	59,919,542	21,571,035	10	5,991,954	8,987,931
5	Bashkia Tropojë	Rikonstruksion i shkollës “Tinka Kurti”, Lekbibaj	29,488,437	13,269,797	10	2,948,844	4,423,266
6	Bashkia Kukës	Ndërtim i terreneve sportive të shkollës Shtiqen	15,590,893	5,456,813	30	4,677,268	2,338,634
		QARKU DURRËS					
7	Bashkia Shijak	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare “Adem Sabli”, fshati Borakë	73,231,332	19,772,460	10	7,323,133	10,984,700
8	Bashkia Krujë	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare dhe ndërtim palestres, Thumanë	70,671,320	19,787,970	30	21,201,396	11,350,698
		QARKU ELBASAN					
9	Bashkia Elbasan	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Jorgji Dilo”, Elbasan	124,187,521	21,732,816	50	62,093,761	31,046,880
10	Bashkia Belsh	Rikonstruksion i shkollës së mesme Sami Frashëri, Belsh	89,987,967	28,346,210	10	8,998,797	8,998,797



11	Bashkia Peqin	Rikonstruksion dhe ndërtim palestere shkolla e mesme “Mustafa Kemal Atatürk”, Pajovë	58,666,068	21,119,784	10	5,866,607	5,866,607
12	Bashkia Librazhd	Shtesë anësore 3 kate dhe ndërtim palestere për shkollën 9-vjeçare “Vilson Blloshmi”, Librazhd	82,881,472	26,107,664	10	8,288,147	7,288,147
		QARKU FIER					
13	Bashkia Lushnje	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “4 Dëshmorët”, Lushnjë	49,881,342	9,976,268	50	24,940,671	12,470,336
14	Bashkia Lushnje	Rikonstruksion i ambienteve të shkollës së bashkuar “Thanas Bozo” dhe ndërtim palestere, Kolonjë	78,525,669	15,705,134	50	39,262,835	19,631,417
15	Bashkia Roskovec	Rikonstruksion godine dhe ndërtim palestere gjimnazi “Adem Vrapit”	99,120,026	31,222,808	10	9,912,003	11,412,003
16	Bashkia Divjakë	Rikonstruksion dhe shtesë anësore 2 kate, i shkollës së mesme të bashkuar, “Mihal Nako” fshati Fier, Seman, Gradisht	81,681,368	20,011,935	30	24,504,410	12,252,205
17	Bashkia Divjakë	Ndërtim kopshti me drekë në Cerme, Sektor	67,261,984	16,479,186	30	20,178,595	10,089,298
18	Bashkia Fier	Rikonstruksion i shkollës së mesme “Jovan Ndreko”, Libofshë	26,241,404	6,560,351	50	13,120,702	6,560,351
19	Bashkia Fier	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Penelopi Pirro”	41,793,855	8,358,771	50	20,896,928	10,448,464
20	Bashkia Patos	Rikonstruksion i shkollës “Mustafa Matohiti”	88,610,769	27,912,392	10	8,861,077	8,861,077
		QARKU KORÇË					
21	Bashkia Pogradec	Rehabilitim i shkollës së mesme “Gjergj Pekmezi”	77,497,937	18,986,995	30	23,249,381	11,624,691
22	Bashkia Pustec	Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar, Pustec	27,097,398	12,193,829	10	2,709,740	2,709,740
23	Bashkia Kolonjë	Rikonsteruksion i shkollës së mesme “Petro Nini Luarasi”, Ersekë	71,447,880	22,506,082	10	7,144,788	7,144,788



24	Bashkia Korçë	Rikonstruktion i shkollës 9-vjeçare, “Nuçi Naci” 3 kate shtesë për palestër	50,000,000	14,000,000	30	15,000,000	7,500,000
		QARKU LEZHË					
25	Bashkia Kurbini	Rikonstruktion i plotë i shkollës 9-vjeçare “Mark Trothi”	97,639,380	27,339,026	30	29,291,814	16,145,907
26	Bashkia Lezhë	Rikonstruktion i shkollës së mesme të bashkuar, “Ishull Lezhë” dhe ndërtim palestere	81,170,727	14,204,877	50	40,585,364	20,292,682
27	Bashkia Mirditë	Rikonstruktion i plotë i kompleksit të godinave 1, 2, 3, shkolla “Vaso Pasha”, Rrëshen	122,093,419	36,917,510	10	12,209,342	12,209,342
28	Bashkia Mirditë	Rikonstruktion dhe sistem ngrohje, palestër dhe sistemim ambienti, shkolla e mesme e bashkuar “Ndrec N. Gjoka”, Fan	72,172,645	25,982,152	10	7,217,265	7,217,265
		QARKU SHKODËR					
29	Bashkia Malësi e Madhe	Rikonstruktion i shkollës “Vasil Shanto”, fshati Vrakë	42,194,347	11,814,417	30	12,658,304	4,219,435
30	Bashkia Fushë Arrëz	Ndërtim i palestrës dhe ambiente sportive, shkolla e mesme “70-vjetori i Pavarësisë”	49,554,052	22,299,323	10	4,955,405	5,955,405
		QARKU TIRANË					
31	Bashkia Kavajë	Rindërtim i shkollës 9-vjeçare Golem, Kavajë	142,515,637	39,904,378	30	42,754,691	21,377,346
32	Bashkia Vorë	Rikonstruktion i plotë dhe shtesë e shkollës “Vajdin Lamaj”, Domje	88,717,281	22,525,730	30	26,615,184	13,307,592
		QARKU VLORE					
33	Bashkia Vlorë	Rikonstruktion i shkollës “24 Maji” dhe ambienteve sportive, Vlorë	99,578,242	19,915,648	50	49,789,121	24,894,561
		TOTALI	2,383,000,689	672,297,118	830	600,987,930	365,313,224

*Shënim.*

1. “Vlera e plotë e projektit” përfaqëson vlerën e plotë të zbatimit të punimeve, sipas projektit (paraqitur nga aplikuesi sipas fazës/projektit që financohet). Diferenca midis vlerës së projektit me vlerën e kontratës (nëse ka një të tillë, pas prokurimit publik dhe mbas nënshkrimit të saj), do t’i zbritet financimit me burim grantet “Arsim bazë”, “Arsimi i mesëm”, pjesë e buxhetit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

2. “Vlera e financimit nga FZHR-ja për vitin 2019” është financimi që jepet për vitin 2019, me burim fondin për projekte të reja, të programit buxhetor “Arsim bazë”, “Arsimi i mesëm”, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për vitin 2019.

3. “Përqindja dhe vlera e plotë e bashkëfinancimit nga NJQV-të”, është sipas pikës 4, të vendimit nr.1, datë 28.2.2019, “Për shpalljen e thirrjes së parë për financimin e projekteve nga grantet “Arsim bazë”, “Arsimi i mesëm”, pjesë e Fondit për Zhvillimin e rajoneve, për vitin 2019” të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, si dhe numrit të popullsisë së bashkisë.

4. “Vlera e financimit nga NJQV-të për vitin 2019” përfaqëson kontributin financiar të bashkisë, në “vlerën e plotë të projektit”, si bashkëfinancim i projektit që merret përsipër të paguhet nga buxheti i vetë aplikuesit/autoritetit kontraktor në vitin 2019.

5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në rolin e sekretariatit teknik të granteve “Arsim bazë”, “Arsimi i mesëm”, bën verifikimin e disponueshmërisë së “vlerës së financimit nga NJQV-të për vitin 2019”, për financimin e projektit, si dhe parashikimin e kësaj vlere nga bashkia, përpara çeljes së fondit që financohet nga FZHR-ja, në favor të autoritetit kontraktues.

6. Likuidimi financiar për financimin nga FZHR-ja të vlerës së projektit (ose për vlerën e kontratës pas prokurimit publik) në vitet në vazhdim do të kryhet nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, duke u bazuar edhe në ecurinë e zbatimit dhe të realizimit të projekteve, programuar në buxhet, me shtrirje në 2 vite (2019–2020).

VENDIM

Nr. 3, datë 27.3.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.12, DATË 16.10.2018, TË KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE, “PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR PROJEKTE TË REJA, THIRRJA II, PËR VITIN 2018, PËR GRANTIN ‘ARSIMI’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16, dhe të aneksit 3, të ligjit nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.12, datë 16.10.2018, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja II, për vitin 2018, për grantin ‘Arsim’”, bëhen ndryshimet sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Erion Braçe

Zëvendëskryeministri	zëvendëskryetar;
Ministri i Financave dhe Ekonomisë	anëtar;
Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Brendshëm	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar.

Tabela 1. Në tabelën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 12, datë 16.10.2018, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja II, për vitin 2018, për grantin ‘Arsim’”, projektit nr. 5 i anulohet financimi dhe bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:



“Tabela 1. Lista e projekteve të reja, thirrja II për vitin 2018, grantet “Arsimi” (arsimi bazë), me cikël zbatimi 2018–2019”

Nr.	Autoriteti kontraktor	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit nga FZHR-ja për vitin 2018 (në lekë)	Vlera e bashkëfinancimit nga NJQV-ja (në lekë)		
					%	Vlera e plotë e bashkëfinancimit (në lekë)	Vlera e bashkëfinancimit për vitin 2018 (në lekë)
	QARKU DURRËS						
5	Bashkia Durrës	Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare “Jusuf Puka”	140,000,000	0	0%	0	0

UDHËZIM

Nr. 284, datë 11.3.2019

PËR PROCEDURËN E MBAJTJES SË AKTIT TË LINDJES SË FËMIJËVE, NË RASTET KUR NUK ËSHTË RESPEKTUAR AFATI KOHOR I REGJISTRIMIT TË TYRE, BRENDA 60 DITËVE NGA DATA E LINDJES

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 40, pika 3 dhe të nenit 41/1, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

UDHËZOJ:

1. Objekt i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave të hollësishme dhe procedurës administrative, që zbatohet nga zyrat e gjendjes civile dhe njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki, në rastin kur nuk është bërë regjistrimi i fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 (në vijim Regjistri Kombëtar), brenda 60 ditëve nga data e lindjes.

2. Kur nëpunësi i gjendjes civile konstaton se, nuk është kryer regjistrimi i fëmijës së lindur në Regjistrin Kombëtar, brenda 60 ditëve nga data e lindjes, njofton me shkresë zyrtare për këtë fakt, drejtuesin e strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki, duke bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin përkatës.

3. Drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki, dërgon për Faqe|3600

trajtim shkresën pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës, brenda 24 orëve nga paraqitja e saj. Në rastin e Bashkisë Tiranë, shkresa i dërgohet çdo njësie administrative që ka njësi të veçantë të mbrojtjes së fëmijës.

4. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës (në vijim *punonjësi për mbrojtjen e fëmijës*) administron shkresën dhe dokumentacionin e dërguar nga nëpunësi i gjendjes civile, si dhe çdo akt tjetër që nxjerr sipas këtij udhëzimi, duke krijuar dosje të veçantë për çdo fëmijë të paregjistruar.

5. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë nga nëpunësi i gjendjes civile, i cili duhet të përgjigjet brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës.

6. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës kontakton menjëherë me prindin/prindërit e fëmijës të paregjistruar në Regjistrin Kombëtar dhe në pamundësi të kontaktit me ta, kontakton me çdo person, që mund të deklarojë lindjen e fëmijës, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 40, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, i ndryshuar dhe, në pamundësi për të kontaktuar edhe me këta persona, i drejtohet subjekteve të përcaktuara në pikën 2, të po këtij neni.

7. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës informon personin e kontaktit përcaktuar në pikën 6, të këtij udhëzimi:

a) për detyrimin për regjistrimin e fëmijës në gjendjen civile sipas legjislacionit në fuqi;

b) për përfitimet dhe domosdoshmërinë e regjistrimit të fëmijës;



c) se në rast se fëmija nuk regjistrohet brenda 60 ditëve nga data e lindjes procedura e regjistrimit të fëmijës kryhet nga njësia për mbrojtjen e fëmijës.

Për takimin e zhvilluar mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të pranishmit dhe, nëse refuzohet nënshkrimi, evidentohet ky fakt. Procesverbali bëhet pjesë e dosjes së fëmijës së paregjistruar.

8. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës cakton një afat prej 10 ditësh nga zhvillimi i takimit sipas pikës 7, me qëllim që personi i kontaktuar sipas pikës 6, të regjistrojë fëmijën në Regjistrin Kombëtar.

9. Pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 8, të këtij udhëzimi, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës verifikon në zyrën e gjendjes civile nëse janë paraqitur personat sipas pikës 6, të këtij udhëzimi, për mbajtjen e aktit të lindjes dhe sipas rastit, kryen veprimet e mëposhtme:

a) nëse fëmija është regjistruar, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës harton raportin përmbledhës për veprimet e kryera, pjesë e të cilit është edhe konkluzioni për mbylljen e dosjes;

b) nëse fëmija nuk është regjistruar, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, në bashkëpunim me nëpunësin e zyrës së gjendjes civile, përcaktojnë emrin e fëmijës, hartojnë aktin e lindjes dhe e nënshkruajnë atë.

Emri i fëmijës, së regjistruar sipas kësaj procedure, është “i përkohshëm” dhe mund të ndryshojë vetëm me kërkesë të personave dhe sipas procedurës, të përcaktuar sipas dispozitave përkatëse të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, për këtë rubrikë dhe vetëm në këto raste.

10. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile dhe punonjësi për mbrojtjen e fëmijës njofton zyrtarisht personin me të cilin ka kontaktuar, sipas pikës 6, të këtij udhëzimi, për regjistrimin e fëmijës, modalitetet e regjistrimit, si dhe i dërgon kopje të aktit të lindjes.

11. Dokumentacioni për regjistrimin e fëmijës, sipas procedurës së parashikuar në këtë udhëzim, hartohet dhe protokollohet në dy kopje, një kopje pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës dhe një kopje në zyrën e gjendjes civile ku është bërë regjistrimi.

12. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, zyrat

e gjendjes civile dhe njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM

Sandër Lleshaj

UDHËZIM

Nr. 285, datë 11.3.2019

PËR KRIJIMIN, ADMINISTRIMIN DHE PËRDITËSIMIN E REGJISTRIT TË PËRKOHSHËM PËR LINDJET E RAPORTUARA

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2, të nenit 41/1, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

UDHËZOJ:

1. Regjistri i Përkohshëm në zbatim të përcaktimeve të bëra në pikën 2, të nenit 41/1, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, është një modul elektronik, në të cilin do të pasqyrohen të dhënat vetëm për rastet e lindjeve të raportuara dhe të paregjistruara në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

2. Regjistri i Përkohshëm, këtu e në vijim i përmendur si “moduli”, do të jetë i integruar në të njëjtin mjedis ku është i integruar Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, pra, portal *web*.

3. Mirëmbajtja dhe zhvillimi i këtij moduli do të realizohet nga subjekti që mirëmban dhe zhvillon portalin *web* të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është institucioni përgjegjës për krijimin, mbajtjen dhe administrimin e të dhënave që ruhen në këtë modul.

Përditësimi i të dhënave bëhet nga nëpunësit e zyrave të gjendjes civile të njësive administrative.

5. Në këtë modul pasqyrohen të dhënat për gjithë të lindurit e paregjistruar, të cilët presumohet se kanë shtetësinë shqiptare, pavarësisht faktit se kanë lindur brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht se kanë lindur në institucione spitalore publike/jopublike apo



jashtë tyre, sipas përcaktimeve të pikës 6, të këtij udhëzimi.

6. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile në njësinë administrative pasqyron në këtë modul të dhënat:

a) për të gjithë fëmijët e lindur në institucione spitalore, për të cilët ka marrë njoftimin prej këtyre institucioneve dhe ndërkohë personat që kanë të drejtën dhe detyrimin e deklarimit nuk janë paraqitur para nëpunësit për të mbajtur aktin e lindjes;

b) për të gjithë të lindurit, për të cilët nëpunësi i gjendjes civile, pasi është njohur me kërkesën e deklaruesit konstaton se nuk mund të mbajë akt lindjeje, për shkak se dokumenti “asistencë në lindje” ose raporti mjekësor është me pasaktësi ose ka rubrika të paplotësuar;

c) për të gjitha rastet kur deklaruesi nuk ka dokument që vërteton lindjen;

ç) për rastet kur akti i lindjes i mbajtur jashtë vendit ka pasaktësi ose është i paplotë në rubrikat e tij;

d) si dhe çdo rast tjetër që konstatohet i paregjistruar, për të cilin nuk mund të mbahet akt lindje në momentin e konstatimit/deklarimit.

7. Të dhënat e pasqyruara në modul do të qëndrojnë aty derisa rasti të zgjidhet. Zgjidhja mund të jetë nëpërmjet rrugës gjyqësore ose rrugës administrative dhe nëpunësi të ketë mundësinë e mbajtjes së aktit të lindjes ose të pasqyrimin të aktit të lindjes të mbajtur jashtë vendit.

8. Të dhënat që përmban moduli janë si më poshtë:

- emri/mbiemri i personit të pa regjistruar;
- emri i babait dhe numri personal i babait (nëse ka);

- emri i nënës dhe numri personal i nënës;

- datëlindja;

- vendlindja;

- gjinia;

- adresa e banimit dhe numri i kontaktit;

- arsyeja e mosregjistrimit;

- dokumentet e paraqitura që mund të jenë:

- i. raportimi nga institucionet e shërbimit spitalor shtetëror, publik ose privat;

- ii. raportime nga institucione të ndryshme;

- iii. raportim nga vetë shtetasit;

- data e regjistrimit në Regjistrin e Përkohshëm;

- data e zgjidhjes së rastit/regjistrimi në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

9. Moduli përmban edhe opsionin e njoftimit të nëpunësit të gjendjes civile, në rastin kur kalohet afati 60-ditor nga data e lindjes.

Me kalimin e afatit 60-ditor të përmendur më lart, nëpunësi i zyrës së gjendjes civile kryen këto veprime:

a) kontrollon nëse të dhënat e regjistruara për lindjen dhe/ose regjistrimin janë regjistruar përfundimisht në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Në rast se është bërë regjistrimi i të dhënave për personin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, atëherë nëpunësi i gjendjes civile vendos në modul shënimin: “E zgjidhur”.

b) në rast se nëpunësi i gjendjes civile konstaton se fëmija nuk është regjistruar ende në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, atëherë kryen veprimet e përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm, “Për procedurën e mbajtjes së aktit të lindjes së fëmijëve, në rastet kur nuk është respektuar afati kohor i regjistrimit të tyre, brenda 60 ditëve nga data e lindjes”.

10. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, në bazë të të dhënave të modulit lëshon vërtetim sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi, pjesë përbërëse e tij.

Vërtetimi i lëshuar nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile i jepet të interesuarit për plotësimin e të drejtave të tij për arsim, trajtim shëndetësor ose përfitim të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, apo në çdo aspekt tjetër për të cilin ka interes të ligjshëm.

11. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe nëpunësit e zyrave të gjendjes civile për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSSHËM
Sandër Lleshaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA _____

NJËSIA ADMINISTRATIVE _____

ZYRA E GJENDJES CIVILE

Nr. _____, prot

Datë _____, _____, _____

VËRTETIM

Emri/mbiemri i personit _____

datëlindja _____

vendlindja _____

emri i babait _____, numri personal dhe,

emri i nënës _____, numri personal,

është i regjistruar në Regjistrin e Përkohshëm të Zyrës së Gjendjes Civile të Njesisë Administrative _____.

Ky dokument lëshohet për efekt _____

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile
Emër / mbiemër **vula**

Shënim:

Ky vërtetim ka burimin dhe gjenerohet nga Regjistri i Përkohshëm që mbahet nga zyra e gjendjes civile.

Ky vërtetim ka vlerë juridike dhe lejohet të përdoret deri në momentin që personi regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

Ky vërtetim është i vlefshëm vetëm për realizimin e të drejtave të ligjshme të personit, të tilla si arsimin, përkujdesje shoqërore, trajtim shëndetësor etj.

Të dhënat që përmban ky vërtetim nuk janë dokument identiteti për personin dhe të dhënat e pasqyruara janë vetëm në bazë të deklarimeve të bëra nga vetë personi/kërkuesi në momentin e regjistrimit në Regjistrin e Përkohshëm.



UDHËZIM

Nr. 286, datë 11.3.2019

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS
ADMINISTRATIVE QË ZBATOHET
NGA ZYRAT E GJENDJES CIVILE KUR
NË AKTIN E LINDJES, MBAJTUR
JASHTË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
ËSHTË E PAPLOTËSUAR RUBRIKA E
EMRIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 45, pika 3/”a” të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

UDHËZOJ:

1. Objekt i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurës administrative, që zbatohet nga zyrat e gjendjes civile, për regjistrimin e fëmijëve në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, në rastet kur në aktin e lindjes së tyre të mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është e paplotësuar vetëm rubrika e emrit të fëmijës.

2. Kërkesa për pasqyrimin e të dhënave të aktit të lindjes, të mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me rubrikën e paplotësuar të emrit, paraqitet nga të dy prindërit/prindi ose nga çdo person i parashikuar sipas ligjit “Për gjendjen civile”, i ndryshuar. Kërkesa paraqitet në zyrën e gjendjes civile ku kanë vendbanimin prindërit/prindi.

3. Personi deklarues, sipas pikës 2, paraqet në zyrën e gjendjes civile ku kanë vendbanimin:

a) kërkesën e nënshkruar prej tyre, sipas formularit 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, pjesë përbërëse e tij;

b) dokumentin origjinal të aktit të lindjes, i cili është në formën e kërkuar nga ligji me vulën “APOSTILLE”, por që ka të paplotësuar rubrikën e emrit;

c) deklaratën me shkrim për emrin që do të mbajë fëmija, sipas formularit 2 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, pjesë përbërëse e tij, duke përfshiruar emrat që janë parashikuar nga aktet nënligjore në fuqi, si të papërshtatshëm për t'u mbajtur;

ç) kopje të letërnjoftimit;

d) prokurën e posaçme, kur nuk është asnjë nga prindërit deklarues.

4. Nëpunësi i gjendjes civile, pasi ka administruar dokumentacionin sipas pikës 3 të këtij udhëzimi, regjistrin fëmijën në Regjistrin Kombëtar me emrin që kanë deklaruar deklaruesit sipas formularit 2, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

Nëpunësi i gjendjes civile në rubrikën “përshkrimi” shënon: “Regjistrim lindjeje sipas aktit nr. __, datë __/__/__, mbajtur në zyrën e gjendjes civile _____ dhe deklaratës së vendosjes së emrit nr. __, datë __/__/__”.

5. Në rastin kur akti i lindjes, i mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ka rubrikën e emrit të paplotësuar dhe nuk përmban vulën “APOSTILLE”, atëherë nëpunësi:

a) këshillon deklaruesin për procedurën ligjore të vendosjes së vulës “APOSTILLE” në aktin e lindjes, kur ai shprehet se do ta kryejë vetë këtë procedurë;

b) kur i interesuari është në pamundësi ta kryejë vetë këtë procedurë, nëpunësi i gjendjes civile duhet:

i) të hartojë një procesverbal në të cilin provon se i interesuari ka depozituar në zyrën e gjendjes civile aktin e lindjes së fëmijës, të mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me rubrikën e emrit të paplotësuar;

ii) të sqarojë deklaruesin për tarifën financiare që duhet të paguajë për këtë shërbim dhe mënyrën e arkëtimit të saj.

Nëpunësi i gjendjes civile, aktin e lindjes të mbajtur me procesverbal, si dhe kopjen e mandatit të arkëtimit në bankë, të tarifës së përcaktuar sipas pikës 6, e dërgon me shkresë zyrtare Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile brenda 48 orëve dhe kjo e fundit e përcjell te strukturat përkatëse të ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme brenda 48 orëve nga data e marrjes. Në këtë rast, deklaruesit i jepet një kopje e procesverbalit, ku të jenë shënuar edhe kontaktet e nevojshme të tyre, së bashku me adresën e tij.

6. Deklaruesit kryejnë pagesën e tarifës së përcaktuar, në numrin e llogarisë bankare të ambasadës apo konsullatës përkatëse, ku do të dërgohet akti për vendosjen e vulës “APOSTILLE”. Këto numra llogarie publikohen pranë çdo zyre të gjendjes civile.



7. Në rast të mosmbajtjes së aktit të lindjes sipas pikës 5 të këtij udhëzimi, nëpunësi i gjendjes civile i regjistron të dhënat e fëmijës në Regjistrin e Përkohshëm, sipas procedurës së parashikuar në udhëzimin përkatës.

8. Në rastin e parashikuar në pikën 5 (“a”) të këtij udhëzimi, kur deklaruesi, risjell në zyrën e gjendjes civile aktin e lindjes së mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me rubrikën e emrit të paplotësuar në të cilën është vendosur vula “APOSTILLE”, nëpunësi i gjendjes civile kryen procedurën e parashikuar në pikën 3 dhe 4 të këtij udhëzimi.

9. Në rastin e parashikuar në pikën 5, (“b”), procedura e regjistrimit fillon pasi mbërrin zyrtarisht në zyrën e gjendjes civile që e dërgoi, akti i lindjes i pajisur me vulën “APOSTILLE”. Pasi merr aktin në formën e kërkuar, nëpunësi i

gjendjes civile njofton deklaruesin dhe, pas paraqitjes së tij, fillon procedurën e parashikuar në pikën 3 dhe 4 të këtij udhëzimi.

10. Pas përfundimit të kësaj procedure, nëpunësi i gjendjes civile pajis deklaruesin me certifikatën e lindjes së fëmijës së regjistruar.

11. Fashikulli i krijuar nga kjo procedurë është me afat ruajtje të përhershme.

12. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, zyrat e gjendjes civile dhe misionet diplomatike e postet konsullore të Republikës së Shqipërisë, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSSHËM
Sandër Lleshaj

Formulari 1

KËRKESË

Drejtuar: Zyrës së Gjendjes Civile të Njesisë Administrative _____

KËRKUES: Z./Znj. _____, i biri _____ dhe _____, e datëlindjes _____, me numër personal _____, banues në adresën: _____ cel. _____ ose numër kontakti: _____

Lënda: Kërkesë për kryerjen e procedurës administrative për regjistrimin e fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, pasi në aktin e lindjes të mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është e paplotësuar rubrika e emrit të personit.

Unë i/e quajturi/a _____, paraqes këtë kërkesë, pranë Zyrës së Gjendjes Civile _____, me anë të së cilës kërkoj, plotësimin e rubrikës së emrit të fëmijës, në aktin e lindjes të mbajtur në _____, sipas deklaratës bashkëlidhur.

Bashkëlidhur paraqes edhe aktin e lindjes origjinal, të mbajtur në shtetin _____.

KËRKUESI

Datë: _____



Nr. _____ Prot.

Datë _____

DEKLARATË E PËRBASHKËT E VENDOSJES SË EMRIT

Sot, më datë ____/____/____, unë i/e nënshkruari/a,

Z./Znj. _____, lindur në _____, më datë ____/____/____,

me numër personal _____, banues/e në _____

në cilësinë e _____, deklaroj se:

fëmija i gjinisë _____, i lindur në _____, më datë ____/____/____,

nga prindërit _____ dhe _____,

do të **quhet** “_____”.

E lëshojmë këtë deklaratë, pasi akti i lindjes me nr. _____, datë ____/____/____, i mbajtur pranë zyrës së gjendjes civile _____, nuk e ka të pasqyruar rubrikën e emrit të fëmijës.

Unë, nëpunësi i gjendjes civile, bazuar në pikën 3/”a”, të nenit 45, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, si dhe mbështetur në deklarinimin e bërë nga _____ dhe pasi verifikova dokumentet përkatëse, konstatova se ato janë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe në vullnetin e lirë dhe të pavarur të deklaruesit.

Për këtë arsye unë e nënshkruaj atë, duke i dhënë forcën e nevojshme ligjore.

Deklaruesi**Nëpunësi i Gjendjes Civile**

Përfaqësuesi me prokurë _____

Bashkëlidhur kësaj deklarate vendoset fotokopja e letërnjoftimit të deklaruesit; kërkesa e tij; akti i lindjes nr. _____, datë _____, i mbajtur nga zyra e Gjendjes Civile e _____.

Ky fashikull është me afat ruajtjeje të përhershme.

**URDHËR****Nr. 208, date 15.3.2019****PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË
ORGANIZATËS SË MENAXHIMIT TË
PESHKIMIT (OMP) TË QARKUT KUKËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 62, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për Peshkimin”, i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural,

VENDOSA:

1. Miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP) të Qarkut Kukës, që i bashkëngjitet këtij urdhri.

2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi**

URDHËR**Nr. 74, datë 21.3.2019****PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM TË
KOMPETENCAVE**

Në zbatim të nenit 28 dhe të nenit 29, të Kodit të Procedurave Administrative, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 29.1.2004, “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, të nenit 26 të rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015, “Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me përjashtim të kompetencave të cilat nuk delegohen dhe që janë të shprehura me ligj, drejtorit të Drejtorisë së Vetting-ut dhe Sigurimit Industrial, z. Mark Ndreca.

2. Ndër të tjera, z. Ndreca ngarkohet edhe me:

- ndjekjen e detyrave të vendosura në planin mujor të muajit mars 2019;

- ndjekjen dhe zbatimin e “Rregullores për funksionimin dhe organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar” (e ndryshuar).

3. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të titullarit në funksion të Kontrollit të Figurës së Subjekteve të Rivlerësimit, përgjegjëses së Sektorit Juridik dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, znj. Marsida Fetishi.

4. Znj. Mardisa Fetishi i delegohen kompetencat si më poshtë:

a) Mbikëqyr dhe udhëzon Grupin e Punës për Kontrollin e Figurës së Subjekteve të Rivlerësimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

b) Përfaqëson Grupin e Punës në marrëdhëniet me:

- Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK);

- Kolegjin e Apelimit (KA) dhe Komisionerët Publikë;

- Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM).

c) Organizon dhe drejton veprimtarinë e Grupit të Punës.

ç) Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për realizimin e qëllimit, objektit dhe detyrave për të cilat është ngritur Grupi i Punës.

5. Mbledhjet e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar (KDZH), do të mbledhen sipas nevojës së procesit të rivlerësimit kalimtar nga nënkryetari i KDZH-së, në përputhje me vendimin nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”.

6. Kompetencat e mësipërme delegohen për periudhën 25.3.2019 deri në 29.3.2019.

7. Z. Mark Ndreca dhe znj. Marsida Fetishi nuk mund t'i nëndelegojnë këto kompetenca.

8. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet Drejtori i Drejtorisë së Vetting-ut dhe Sigurimit Industrial, z. Mark Ndreca.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

10. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**DREJTORI
Dorian Tola**

**VENDIM**

Nr. 50, datë 19.3.2019

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“MBI KRITERET DHE PROCEDURËN
PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE
PËR PROKURORË TË PËRGJITHSHËM
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 148/a, 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 22–35 dhe 115, pika 1, të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 189, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Mbi kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve për prokurorë të përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Gent Ibrahimi**

RREGULLORE

**MBI KRITERET DHE PROCEDURËN PËR
PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE PËR
PROKURORË TË PËRGJITHSHËM TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

KREU I**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1****Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave që lejojnë Këshillin e Lartë të Prokurorisë të kryejë një proces objektiv, transparent, dhe gjithëpërfshirës për përzgjedhjen, renditjen dhe propozimin e tre kandidatëve për prokurorë të përgjithshëm.

Procesi i vlerësimit dhe përzgjedhjes bazohet dhe respekton parimin e drejtësisë, barazisë dhe mosdiskriminimit.

Neni 2**Përkufizime**

Termat e përdorur në këtë rregullore, kanë këto kuptime:

a) “Ditë” ka kuptimin e ditës kalendarike; nëse dita e fundit është ditë pushimi, atëherë përfundimi i afatit do të shtyhet në ditën pasardhëse të punës.

b) “Këshilli” është Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

c) “Institucionet e rivlerësimit” janë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit.

ç) “Konfirmuar pas rivlerësimit” konsiderohet kandidati i konfirmuar në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, vendimi i të cilit nuk është ankimuar brenda afatit ligjor ose pas ankimit, kandidati që është konfirmuar në detyrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

d) “Ligji për prokurorinë” është ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë.”

dh) “Ligji për qeverisjen” është ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë.”

e) “Gradë shkencore në drejtësi” konsiderohet grada “Doktor” sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, e fituar në Republikën e Shqipërisë ose në një vend tjetër, me kusht që të jetë njohur dhe vlerësuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në Republikën e Shqipërisë.

ë) “Titull akademik” konsiderohet titulli Profesor i Asociuar, Profesor dhe Akademik, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, fituar në Republikën e Shqipërisë ose në një vend tjetër, me kusht që të jetë njohur dhe vlerësuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në Republikën e Shqipërisë.

f) “Funksion politik në administratën publike” konsiderohet çdo funksion i përcaktuar në nenin 2, germa “ç”, i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3**Procesi i përgjithshëm i përzgjedhjes**

1. Këshilli shpall thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm, sipas rregullave të parashikuara në nenet 29 dhe 30, të ligjit për prokurorinë. Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit



qëndron e hapur për 30 ditë, sipas nenit 30, të ligjit për prokurorinë.

2. Këshilli përcakton në thirrje adresën e postës elektronike, si dhe adresën postare në të cilën aplikantët dorëzojnë shprehjet e interesit.

3. Pas përfundimit të afatit 30-ditor për paraqitjen e shprehjes së interesit, Këshilli publikon në faqen e tij zyrtare emrat e kandidatëve.

4. Brenda 45 ditëve nga përfundimi i afatit të dorëzimit të shprehjeve të interesit, Këshilli kryen vlerësimin paraprak, me qëllim verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore, të përcaktuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje. Këshilli pret përfundimin e procedurave të rivlerësimit për kandidatët që i nënshtrohen këtij procesi deri në konfirmimin e tyre. Nëse është e nevojshme, Këshilli kërkon informacione të mëtejshme prej kandidatit, institucioneve publike, apo punëdhënësit të kandidatit, sipas parashikimeve ligjore të neneve 30 dhe 31, të ligjit për prokurorinë.

5. Në përfundim të vlerësimit paraprak, Këshilli harton listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore dhe të kandidatëve që nuk i plotësojnë këto kushte bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati dhe dokumentacionin shtesë të mbledhur nga Këshilli.

6. Këshilli merr vendim për përjashtimin e kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet ligjore dhe i njofton me shkrim kandidatët e përjashtuar, në mënyrë të posaçme dhe të arsyetuar për shkaqet e përjashtimit.

7. Pas përfundimit të afatit të ankimit për vendimet e përjashtimit, Këshilli mblidhet dhe miraton listën përfundimtare të kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore.

8. Këshilli organizon seancë dëgjimore me kandidatët dhe i njofton ata të paktën 10 ditë para seancës dëgjimore. Anëtarët e Këshillit i drejtojnë pyetje kandidatit në përputhje me kriteret e vlerësimit sipas kësaj rregulloreje.

9. Anëtarët e Këshillit vlerësojnë të gjithë informacionin e vënë në dispozicion prej kandidatëve, dokumentacionin e mbledhur dhe informacionin e marrë gjatë seancës dëgjimore, në përputhje me këtë rregullore, dhe i dorëzojnë kryetarit të Këshillit vlerësimet me shkrim për secilin kandidat.

10. Kryetari i Këshillit lexon gjatë mbledhjes së hapur, vlerësimin e dhënë prej secilit anëtar të Këshillit dhe kryen renditjen e kandidatëve. Këshilli i dorëzon Kuvendit listën me tre kandidatët me renditjen më të lartë, pas përfundimit të procesit të ankimit për renditje, sipas parashikimeve të ligjit.

11. Në rast konflikti ndërmjet parashikimeve të këtij neni dhe parashikimeve me të detajuara në vijim, ka përparësi neni me parashikime me të detajuara.

KREU II

Neni 4

Kushtet ligjore për emërimin e prokurorit të përgjithshëm

1. Kandidati për prokuror i përgjithshëm paraqet dokumente që provojnë se plotëson kushtet e parashikuara në nenin 22, të ligjit për prokurorinë. Kandidati dorëzon dokumente mbështetëse për secilin prej kushteve ligjore si më poshtë:

a) të ketë 15 vjet përvojë pune si jurist i spikatur;
b) të jetë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës ose të ketë gradë shkencore në drejtësi;
c) të mos ketë mbushur moshën e daljes në pension sipas nenit 64, pika 3, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Kandidatët nënshkruajnë nën përgjegjësinë e tyre deklaratat mbi kriteret e mëposhtme:

a) të mos kenë mbajtur gjatë 10 viteve të fundit, para dorëzimit të shprehjes së interesit për prokurorë të përgjithshëm, funksione politike në administratën publike;

b) të mos kenë mbajtur gjatë 10 viteve të fundit pozicione drejtuese në parti të politike;

c) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

ç) të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

d) të mos kenë qenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve të inteligjencës;

dh) të mos kenë masë disiplinore në fuqi.



3. Kandidatët duhet të dorëzojnë vetëdeklarimin sipas ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

4. Kandidatët duhet të kalojnë me sukses verifikimin e plotë të pasurisë dhe figurës, sipas ligjit. Nëse kandidati është subjekt i ligjit të rivlerësimit, ai/ajo duhet të konfirmohet pas rivlerësimit me vendim të formës së prerë. Nëse kandidati nuk është subjekt i ligjit të rivlerësimit, Këshilli kryen verifikimin e plotë sipas nenit 31, të ligjit për prokurorinë.

5. Në rast konflikti ndërmjet këtij neni dhe neneve të cilat parashikojnë rregullime të posaçme për secilin hap të procedurës, neni me parashikime të posaçme ka përparësi.

Neni 5

Vlerësimi i kandidatëve

1. Kandidatët që përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 4, vlerësohen dhe renditen sipas kriterëve në vijim:

a) integriteti profesional i kandidatit në fushën e drejtësisë penale, sipas parashikimeve të detajuara në nenin 6 të kësaj rregulloreje;

b) integriteti moral i kandidatit, sipas parashikimeve të detajuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje;

c) aftësitë organizative dhe drejtuese, sipas parashikimeve të detajuara në nenin 8 të kësaj rregulloreje;

ç) elementet plotësuese për vlerësim sipas parashikimeve të detajuara në nenin 9 të kësaj rregulloreje.

2. Në rastet kur kandidatët kanë të njëjtën meritë, vlerësohet vjetërsia në ushtrimin e profesionit dhe eksperiencën profesionale.

3. Në rast konflikti ndërmjet parashikimeve të këtij neni dhe parashikimeve me të detajuara në vijim, ka përparësi neni me parashikime me të detajuara.

Neni 6

Vlerësimi i integritetit profesional

1. Vlerësimi profesional i çdo kandidati bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) kohëzgjatja dhe përshtatshmëria e përvojës në punë me pozicionin për të cilin konkurron (1–5 pikë);

b) rezultatet e vlerësimeve profesionale ose etike të kandidatëve në pozicionet e mëparshme, nëse ka, ose rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën e drejtësisë penale (1–5 pikë);

c) rezultatet e arritura gjatë studimeve të larta gjatë trajnimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, si dhe pjesëmarrja në trajnimin vazhdues dhe në kurse trajnimi të certifikuar në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë (1–3 pikë);

ç) rezultatet e arritura gjatë studimeve pasuniversitare në fushën e së drejtës penale (1–3 pikë);

d) punime akademike, studime shkencore, shkrime dhe ligjërata profesionale, botime, pjesëmarrje në aktivitete shkencore (përveç atyre që kanë shërbyer për fitimin e gradës shkencore), pjesëmarrje në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional i kandidatit gjatë 5 viteve të fundit në fushën e së drejtës (1–4 pikë).

Neni 7

Vlerësimi i integritetit moral

1. Vlerësimi i çdo kandidati në lidhje me integritetin moral bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) reputacioni që kandidati gëzon në shoqëri dhe te kolegët, si rezultat i aktivitetit të tij profesional bazuar në cilësitë morale si ndershmëria, përpikëria në kryerjen e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve dhe llogaridhënia (1–2 pikë);

b) reputacioni që kandidati gëzon në shoqëri dhe te kolegët, si rezultat i aktiviteteve të kryera gjatë kohës që nuk ushtron funksionin e tij bazuar në cilësitë morale si besueshmëria, paanshmëria, dinjiteti, veprimtaritë sociale ose kulturore (1–2 pikë).

2. Vlerësimi për integritetin moral bëhet përmes dokumenteve të dorëzuara nga kandidatët, dokumenteve të mbledhura nga Këshilli, të dhënave nga seancat dëgjimore, raportimeve në media, të dhënave publike ose burimeve të tjera të besueshme.

Neni 8

Vlerësimi i aftësive organizative dhe drejtuese

1. Vlerësimi i çdo kandidati për aftësitë organizative dhe drejtuese bazohet në kriteret e mëposhtme:



a) cilësia e platformës dhe vizionit që ata paraqesin sipas shtojcës A të kësaj rregulloreje (1–5 pikë);

b) aftësitë e provuara në marrjen e vendimeve dhe përgjegjësi, bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore (1–5 pikë);

c) aftësitë në komunikim (1–4 pikë);

ç) aftësia për të punuar në grup dhe në mjedise multidisiplinare dhe/ose multikulturore (1 - 3 pikë);

d) aftësia për përfaqësim në publik (1–3 pikë).

2. Këshilli vlerëson përmbushjen e kriterëve të mësipërme bazuar në dokumentet e dorëzuara nga kandidati, të mbledhura nga Këshilli dhe të dhëna të mbledhura gjatë seancës dëgjimore me kandidatin.

3. Kandidati ka barrën për të sjellë prova që tregojnë aftësitë organizative dhe drejtuese të renditura në pikën 1 të këtij neni.

Neni 9

Elemente shitesë për vlerësim

1. Vlerësimi i secilit kandidat për elemente shitesë sipas nenit 27 të ligjit për prokurorinë bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) mbajtja e titujve akademikë (1 pikë për çdo titull deri në 2 pikë totali);

b) studimet dhe trajnimet afatgjata të kryera jashtë vendit jo më pak se dy javë në fushën e së drejtës penale ose menaxheriale (deri në 2 pikë);

c) zotërimi i gjuhëve të huaja duke i dhënë përparësi gjuhëve zyrtare të Këshillit të Evropës:

i. për çdo gjuhë të huaj, të cilën kandidati e njeh shumë mirë, vlerësohet me 1 pikë;

ii. për çdo gjuhë të huaj, të cilën kandidati e njeh në nivel pune, vlerësohet me 0.5 pikë.

Kandidati mund të fitojë maksimumi 2 pikë për këtë element.

2. Këshilli vlerëson zotërimin e gjuhëve të huaja përmes dokumenteve zyrtare të njohura të dorëzuara dhe/ose përmes intervistës me kandidatin. Këshilli mund të angazhojë një pedagog ose specialist të certifikuar për vlerësimin e nivelit të zotërimit të gjuhës.

KREU III

PROCEDURA E APLIKIMIT

Neni 10

Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit

1. Menjëherë pas miratimit të kësaj rregulloreje, Këshilli shpall thirrjen për paraqitjen e shprehjes së

interesit për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Thirrja shpallet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe në dy gazetatat më të lexuara në nivel kombëtar ose me lajmërim në mediat audiovizive kombëtare.

3. Thirrja qëndron e hapur për 30 ditë. Afati fillon nga e nesërme e shpalljes ose e publikimit dhe përfundon në orën 23:59 të ditës së fundit. Ky afat mund të zgjatet me vendim të Këshillit.

Neni 11

Shprehja e interesit

1. Kandidatët paraqesin një kërkesë me shkrim drejtuar Këshillit për të shprehur interesin dhe për të dëshmuar kualifikimet e tyre për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Kandidati duhet të paraqesë një aplikim të plotë në mënyrë që të merret në konsideratë. Vlerësimi bëhet mbi bazën e dokumenteve të dorëzuara.

3. Kërkesa me shkrim shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

a) një jetëshkrim i përditësuar;

b) një platformë personale e qëllimeve dhe objektivave që kandidati propozon të ndjekë. Ky dokument duhet të jetë punë origjinale e kandidatit dhe nuk duhet të kalojë 20 faqe, në llojin e shkrimit Times New Roman, madhësia 12, me një njësi hapësire mes rreshtave;

c) një deklaratë nën përgjegjësi ligjore se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor apo i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit para vitit 1990;

ç) një deklaratë nën përgjegjësi ligjore se nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve sekrete;

d) një vetëdeklarim sipas ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave të zgjedhur, emëruar ose që marrin funksione publike”;

dh) formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë”, të hartuar nga ILDKPI-ja në zbatim të nenit 3/1 të ligjit nr. 9049/2003, në zarf të mbyllur, për kandidatët që nuk janë subjekte të rivlerësimit;

e) dëshmi të gjendjes gjyqësore lëshuar nga organi kompetent shtetëror;

ë) vërtetimin/dokumentacionin e përshtatshëm që provon përvojën e punës së kandidatit për pozicionin për të cilin konkurron;



f) rezultatet e vlerësimit profesional dhe etik të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, apo rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës, që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën e drejtësisë penale;

g) rezultatet e arritura gjatë studimeve të larta, gjatë formimit fillestar dhe atij të vazhdueshëm në Shkollën e Magjistraturës, dhe në trajnime dhe kurse të certifikuara, brenda dhe jashtë vendit;

gj) rezultatet e arritura gjatë studimeve pasuniversitare në fushën e së drejtës penale;

h) kopje të noterizuara të dëshmimeve të gjuhëve të huaja sipas pikës 1, germa “c”, të nenit 9 të kësaj rregulloreje nëse ka;

i) kopje të noterizuara të gradës shkencore ose titujve akademikë nëse ka;

j) autorizimet për Këshillin sipas shtojcave B dhe C të kësaj rregulloreje.

4. Shprehja e interesit dhe të gjitha dokumentet e kërkuara duhet t'i dorëzohen Këshillit deri në datën dhe orën e përfundimit të afatit, në adresën postare ose në adresën elektronike të shënuar në thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit.

Neni 12

Publikimi i shprehjeve të interesit

Pas kalimit të afatit për të paraqitur shprehje interesi, Këshilli shqyrton aplikimet dhe publikon menjëherë emrat e aplikantëve në faqen zyrtare të Këshillit. Publikimi duhet të bëhet jo më vonë se 3 ditë pune pas mbylljes së thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit.

Neni 13

Informacion shtesë përveç shprehjes së interesit

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kur e sheh të nevojshme, kërkon informacione të mëtejshme nga kandidatët, organet publike ose punëdhënësi i kandidatit.

2. Kërkesa duhet të përshkruajë qartë informacionin që nevojitet dhe të përcaktojë afatin dhe vendin e paraqitjes së tij.

KREU IV

PROCEDURA PËR VLERËSIMIN PARAPRAK

Neni 14

Kërkimi i informacionit nga institucionet shtetërore

1. Këshilli, sa më shpejt të jetë e mundur, paraqet emrat e kandidatëve në institucionet përkatëse, si më poshtë:

a) një listë e kandidatëve që janë subjekte të ligjit të vlerësimit por ende të pakonfirmuar, i dërgohet Komisionit të Pavarur të Kualifikimit/ Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me kërkesën për të kryer rivlerësim me përparësi;

b) një listë e kandidatëve që janë gjyqtarë i dërgohet Këshillit të Lartë Gjyqësor, me qëllim marrjen e kopjeve të çdo dokumenti disiplinor ose informacioni tjetër lidhur me vlerësimin;

c) një listë e kandidatëve që janë avokatë i dërgohet Dhomës Kombëtare të Avokatisë, me qëllim marrjen e kopjeve të çdo të dhëne disiplinore ose informacion tjetër lidhur me vlerësimin;

ç) lista me emrat e kandidatëve që nuk janë subjekte të rivlerësimit u dërgohet organeve tatimore dhe doganore, Shërbimit Informativ Shtetëror, Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit Shtetëror, Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si dhe Prokurorisë për informacione të mundshme të lidhura me kandidatët, si dhe çdo institucion tjetër që do të çmohet e nevojshme.

d) Këshilli i Lartë i Prokurorisë mund të kërkojë informacion shtesë nga DSIK-ja, SHISH-i ose ILDKPKI-ja për fakte të ndodhura pas vendimit të organeve të rivlerësimit për konfirmimin në detyrë të kandidatëve që janë subjekte të vlerësimit.

Neni 15

Verifikimi i pasurisë së kandidatit

1. Kandidati dorëzon bashkë me aplikimin pranë Këshillit, kopjen fizike të formularit “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë”, të hartuar nga ILDKPKI-ja në zbatim të nenit 3/1, të ligjit nr. 9049/2003, në zarf të mbyllur.



2. Njëkohësisht, kandidati dorëzon formularin e autorizimit për Këshillin sipas shtojcës B. Këshilli në zbatim të pikës 2, të nenit 31, të ligjit për prokurorinë, mund të kryejë verifikimin në të gjitha subjektet publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit dhe personave të lidhur. Autorizimet nënshkruhen rregullisht nga kandidati dhe personat e lidhur, si pjesë e dokumentacionit për aplikim.

3. Jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i afatit të aplikimeve, Këshilli i dërgon ILDKPKI-së listën e kandidatëve që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas ligjit për prokurorinë. Këshilli mund kryejë kërkime pranë subjekteve publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, për të dhëna mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit dhe personave të lidhur paralelisht me hetimet e kryera nga institucionet përgjegjëse.

4. ILDKPKI-ja kryen kontrollin e plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe interesave private të kandidatit jo më vonë se 30 ditë nga paraqitja e deklaratës pranë ILDKPKI-së.

5. Nëse gjatë 180 ditëve para paraqitjes së Deklaratës, kandidati i është nënshtuar kontrollit të plotë nga ILDKPKI-ja dhe kontrolli nuk ka rezultuar në disfavor të tij, si edhe në rastin kur ILDKPKI-ja vlerëson se nuk është vendi për rikontroll të plotë sipas përcaktimit të pikës 4 të nenit 25/1 të ligjit nr. 9049/2003, atëherë kontrolli konsiderohet i kryer. ILDKPKI-ja i dërgon menjëherë Këshillit kopjen e deklaramit të bërë nga kandidati, si edhe gjetjet dhe përfundimet e këtij institucioni pas kryerjes së kontrollit të plotë të deklarimit.

6. Pavarësisht parashikimit të pikës 5 të këtij neni, nëse pas fillimit të procedurës së verifikimit të kandidatit, Këshilli vihet në dijeni nga burime të ligjshme, të rrethanave që vënë në dyshim vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave që përmbahen në deklarimin e pasurisë së kandidatit, njofton menjëherë ILDKPKI-në për të ushtruar kompetencën e rikontrollit të plotë të deklarimit të kandidatit sipas parashikimeve të ligjit nr.

9049/2003, neneve 3/1, 25/1, pika 4, të tij.

7. Në përfundim të verifikimit të kryer sipas ligjit, ILDKPKI-ja i dërgon menjëherë Këshillit raportin e kontrollit të plotë për pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare të kandidatit dhe personave të lidhur.

8. Këshilli shqyrton rezultatet e kontrollit, gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI-së, si dhe të dhënat mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare të kandidatit dhe personave të lidhur, të dërguara nga subjektet publike dhe private sipas kërkesës së Këshillit.

9. Në varësi të rezultateve të kontrollit dhe nevojave të verifikimit të mëtejshëm të pasurisë, Këshilli mund të kërkojë:

a) informacione shtesë nga subjektet publike dhe private;

b) shpjegime me shkrim nga kandidati, i cili, jo më vonë se 5 ditë nga marrja dijeni, duhet të paraqesë drejtpërdrejt pranë Këshillit shpjegimet e tij dhe dokumentet mbështetës ose shprehjen e vullnetit për tërheqjen nga kandidimi.

10. Në rastin kur në verifikimin e pasurisë lind nevoja për njohuri të posaçme lidhur me konstatimin dhe sqarimin e të dhënave që rezultojnë nga deklaramit e kandidatit, gjetjet dhe përfundimet e ILDKPKI-së dhe atyre të sjella nga subjektet publike e private, Këshilli mund të thërrasë ekspertë të pavarur ose që ushtrojnë veprimtarinë në institucione të specializuara. Shpenzimet për ekspertët përballohen nga buxheti i Këshillit.

11. Eksperti ka detyrimin të shqyrtojë aktet sipas udhëzimeve të Këshillit, të përgatisë, sipas rastit, raportin financiar apo mendimin e tij me shkrim, si edhe të ruajë konfidencialitetin e të dhënave që siguron gjatë kryerjes së ekspertimit.

12. Kur e vlerëson, Këshilli mund të thërrasë ekspertin për të dhënë shpjegime në mbledhjen e Këshillit. Në vendimin e arsyetuar të Këshillit për vijimin e kandidimit ose skualifikimin e kandidatit, trajtohet edhe nevoja për ekspertim dhe mendimi i dhënë nga eksperti.

13. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI-së, atyre të nxjerra nga të dhënat që rezultojnë nga shkresat e dërguara nga subjektet publike dhe private, si edhe nga shpjegimet me shkrim të dhëna nga kandidati, Këshilli i vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin e kandidimit, procedon me përgatitjen e pjesës së



relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të pasurisë.

14. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI-së, atyre të nxjerra nga të dhënat që rezultojnë nga shkresat e dërguara nga subjektet publike dhe private, si edhe nga shpjegimet me shkrim të dhëna nga kandidati, Këshilli vlerëson se ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin e kandidimit, procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të pasurisë dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

15. Këshilli përjashton nga gara kandidatët në rastet kur ka të dhëna nga burime të ligjshme se kandidati:

a) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;

b) ka fshehur pasurinë dhe të dhënat mbi interesat private, që janë të detyrueshme të deklarohen;

c) ka kryer deklarim të rremë;

ç) ka kryer deklarime të pasakta të pasurisë dhe të interesave private;

d) gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

16. Këshilli përjashton nga gara kandidatin në rastet kur kandidati:

a) ka refuzuar të përmbushë detyrimin për të plotësuar dhe dorëzuar në afat formularin e deklaratës së pasurisë;

b) ka refuzuar nënshkrimin e autorizimeve të kërkuara nga Këshilli për verifikimin e pasurisë.

Neni 16

Verifikimi i integritetit të kandidatit

1. Kandidati dorëzon bashkë me aplikimin pranë Këshillit, kopjen fizike të formularit për vetëdeklarim sipas ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe formularin e aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta” sipas ligjit nr. 45/2015 të plotësuar sipas ligjit, në rrugë elektronike.

2. Formulari i aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta” sipas nenit 29 të ligjit nr. 45/2015, i plotësuar nga kandidati, i dërgohet menjëherë për kompetencë shqyrtimi, Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Faqe|3614

Sigurimit të Shtetit. Kryetari i Këshillit e përcjell menjëherë formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015, të plotësuar nga kandidati, në Prokurorisë së Përgjithshme. Vetëdeklarimi i kandidatit sipas ligjit nr. 138/2015 bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

3. Prokuroria e Përgjithshme kryen verifikimet sipas ligjit jo më vonë se 30 ditë nga paraqitja e vetëdeklarimit pranë atij institucioni.

4. Këshilli mund të kryejë edhe veprimet për kërkimin e informacionit, sipas kompetencës përkatëse, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi Informativ i Shtetit, shërbimet e tjera të inteligjencës dhe prokuroria. Kandidati plotëson dhe nënshkruan autorizimin sipas shtojcës C të kësaj rregulloreje, ku autorizon Këshillin të kryejë verifikimet përkatëse.

5. Në varësi të rezultateve të kontrollit dhe nevojave të verifikimit të mëtejshëm të integritetit të kandidatit, Këshilli mund të kërkojë:

a) informacione shtesë nga institucionet e përmendura në këtë nen;

b) shpjegime me shkrim nga kandidati, i cili, jo më vonë se 5 ditë nga marrja dijeni, duhet të paraqesë drejtpërdrejt pranë Këshillit, shpjegimet e tij dhe dokumentet mbështetës ose shprehjen e vullnetit për tërheqjen nga kandidimi.

6. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të Prokurorisë së Përgjithshme, si edhe gjetjet e përfundimet e nxjerra nga të dhënat e dërguara nga institucionet e tjera të përmendura në këtë nen, Këshilli vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen e pjesës së relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të integritetit të kandidatit.

7. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të Prokurorisë së Përgjithshme, si edhe të atyre të dërguara nga institucionet e tjera të përmendura në këtë nen, Këshilli vlerëson se ka të dhëna që mund të sjellin përjashtimin e kandidatit, procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të integritetit.

8. Këshilli përjashton nga gara kandidatët në rastet kur nga Prokuroria e Përgjithshme dhe institucionet e tjera të përmendura në këtë nen, konfirmohet se kandidati:



a) ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar;

b) ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

c) është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës.

9. Përjashtimi vendoset edhe kur kandidati ka refuzuar të përmbushë detyrimin për t’u pajisur me formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 ose me formularin e aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta” sipas ligjit nr. 45/2015 apo nuk i ka plotësuar ato.

Neni 17

Verifikimi i kushteve ligjore

1. Këshilli shqyrton dokumentet e dorëzuara nga kandidatët dhe nga institucionet brenda 45 ditëve nga dita e mbylljes së thirrjes për dorëzimin e dokumenteve, me qëllim verifikimin kushteve ligjore të parashikuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje.

2. Këshilli përcakton nëse do të kërkohej informacion shtesë nga kandidati, institucioni shtetëror ose punëdhënësi i kandidatit. Këshilli kërkon informacion shtesë në përputhje me procesin e parashikuar në nenin 14 të kësaj rregulloreje.

3. Nëse Këshilli nuk merr informacion të mjaftueshëm për të përmbushur detyrën e tij për verifikimin e kriterëve ligjore, mund të vendosë një afat shtesë për të marrë informacionin e duhur.

4. Këshilli harton një listë të kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore dhe një listë të atyre që nuk plotësojnë kushtet ligjore së bashku me një raport mbi rezultatet e verifikimit të kriterëve ligjore bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe atë të mbledhur.

5. Këshilli merr vendim për përjashtimin e kandidatëve dhe njofton me shkrim dhe në mënyrë të arsyetuar çdo person të përjashtuar. Njoftimet nënshkruhen nga kryetari dhe i dërgohen secilit kandidat të përjashtuar, me postë rekomandë, ditën vijuese të punës.

6. Këshilli nuk ndërmerr veprime të mëtejshme deri në përfundimin e procesit të ankimit ose veprimeve të Gjykatës Administrative të Apelit, në përputhje me nenin 31 të ligjit mbi prokurorinë.

KREU V

PROCEDURA PËR VLERËSIMIN NGA KËSHILLI

Neni 18

Përfundimi i verifikimit të kriterëve ligjore dhe përjashtimi i kandidatëve

1. Seancat dëgjimore do të planifikohen për të gjithë kandidatët e kualifikuar, pasi:

a) ka përfunduar procesi i ankimimit për kandidatët e përjashtuar në fazën e vlerësimit paraprak;

b) ka përfunduar procesi i rivlerësimit për kandidatët subjekte të ligjit të rivlerësimit;

c) janë dhënë vlerësime negative mbi pasurinë dhe kontrollin e figurës nga institucionet përkatëse për kandidatët jo subjekte të ligjit të rivlerësimit. Këta të fundit përjashtohen nga vlerësimi i mëtejshëm me vendim të këshillit. Vendimi mund të merret në seancë të mbyllur, nëse konsiderohet e nevojshme.

2. Kandidatët duhet të njoftohen me shkresë zyrtare/postë elektronike dhe nëpërmjet telefonit për datën e seancës dëgjimore të paktën 10 ditë para zhvillimit të saj. Nëse kandidati kërkon një datë ose kohë tjetër, seanca mund të zhvillohet brenda kësaj periudhe 10-ditore.

3. Orari i seancave dëgjimore publikohet sa më shpejt të jetë e mundur në faqen e internetit të Këshillit.

Neni 19

Zhvillimi i seancave dëgjimore

1. Këshilli cakton datën dhe orën e seancës dëgjimore. Seanca për secilin kandidat mbahet në praninë e më shumë se gjysmës së anëtarëve të Këshillit. Seanca regjistrohet.

2. Seanca dëgjimore fillon me raportimin e Këshillit për secilin kandidat. Raporti trajton në mënyrë të hollësishme e të justifikuar të gjitha kriteret e vlerësimit të parashikuar nga nenet 6–9 të kësaj rregulloreje.

3. Pas raportimit, i jepet fjala kandidatit i cili ka në dispozicion 10 minuta për të bërë një prezantim.

4. Pas prezantimit, çdo anëtar i Këshillit ka të drejtë t’i drejtojë pyetjet kandidatit. Pyetjet do të



përqendrohen në kompetencën e kandidatit në fushën e:

a) rezultateve të vlerësimit profesional të kandidatit në fushën e drejtësisë penale, sipas parashikimeve të detajuara në nenin 6;

b) integritetit moral të kandidatit, sipas parashikimeve të detajuara në nenin 7;

c) aftësive organizative dhe drejtuese, sipas parashikimeve të detajuara në nenin 8;

ç) elementeve shtesë të vlerësimit sipas parashikimeve të detajuara në nenin 9.

5. Kandidatëve u lihet kohë e mjaftueshme në dispozicion për t'u përgjigjur për çdo pyetje.

6. Këshilli kërkon nga kandidatët të provojnë rezultatet e punës dhe rastet që mbështesin këto rezultate në përputhje me kriteret e vlerësimit sipas nenit 6–9 të kësaj rregulloreje. Kandidatët do të kenë 5 ditë për të identifikuar këto dokumente dhe për t'ia vënë ato në dispozicion Këshillit.

7. Këshilli mund të kërkojë informacion shtesë nga burimet përkatëse në përputhje me nenin 14 të kësaj rregulloreje.

8. Pas përfundimit të seancës dëgjimore, Këshilli zhvillon një seancë të mbyllur për të vlerësuar cilësitë e secilit kandidat. Këshilli do të shqyrtojë çdo dokument të nevojshëm për vlerësuar sa më mirë kandidatin.

Neni 20

Procedura e vlerësimit

Secili nga anëtarët e Këshillit do të përdorë formularin e vlerësimit në shtojcën D të kësaj rregulloreje. Anëtari do të përdorë dokumentet në dispozicion dhe informacionin e dhënë gjatë seancës dëgjimore për të përfunduar vlerësimin. Anëtarët e Këshillit i dorëzojnë vlerësimet për secilin kandidat kryetarit të Këshillit.

Neni 21

Vendimarrja përfundimtare e Këshillit

1. Brenda 24 orëve nga seanca e fundit dëgjimore, Këshilli përpunon të dhënat dhe harton tabelën përfundimtare të vlerësimit të kandidatëve sipas shtojcës E bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Këshilli rendit kandidatët sipas pikëve të marra duke filluar nga kandidati që ka marrë më shumë pikë.

2. Në rastet kur kandidatët kanë pikë të barabarta, ata do të listohen në bazë të vjetërsisë në profesion dhe në përvojën profesionale.

3. Në përfundim të renditjes, Këshilli merr vendim për përfundimin e procesit të përzgjedhjes dhe renditjen e kandidatëve për prokurorë të përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë. Vendimi i Këshillit shoqërohet me një relacion i cili shpjegon analizën dhe masën e përmbushjes për secilin kriter për çdo kandidat, si dhe metodologjinë e ndjekur për vlerësimin e njëkohshëm dhe krahasimor të masës së përmbushjes së kriterëve prej kandidatëve.

4. Kandidatët kanë të drejtë të ankimojnë vendimin e Këshillit.

5. Kur Gjykata pranon me vendim të formës së prerë ankimin dhe shfuqizon vendimin, Këshilli rishikon vendimin e renditjes së kandidatëve brenda dy javëve nga marrja e vendimit të gjykatës, deri në masën e nevojshme në përputhje me gjetjet e gjykatës.

6. Këshilli publikon vendimin përfundimtar në faqen zyrtare të tij, duke përfshirë arsyetimin e vendimit, referuar verifikimit të kushteve ligjore, vlerësimit dhe renditjes së kandidatëve të kualifikuar dhe i paraqet Kuvendit të Shqipërisë propozimin për të emëruar si prokurorë të përgjithshëm tre kandidatët e renditur më lart në listë. Propozimi përfshin vendimin e arsyetuar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 22

Konflikti i interesit

Anëtari i Këshillit, që ka pengesa ligjore në kuptim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe ka konflikt interesi në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, heq dorë nga detyrat e tij/saj në procesin e vlerësimit dhe renditjes së kandidatëve.

Neni 23

Komunikimet jozyrtare gjatë procesit të përzgjedhjes

Anëtarët e Këshillit dhe kandidatët për prokurorë të përgjithshëm duhet të shmangin komunikimet jozyrtare mes tyre, duke filluar nga



data e miratimit të kësaj rregulloreje deri në ditën e miratimit të vendimit të Këshillit për renditjen e kandidatëve.

Neni 24

Monitoruesit e procesit të vlerësimit

Monitorues të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës mund të marrin pjesë në seancat dëgjimore me kandidatët. Ata mund të drejtojnë pyetje gjatë seancave dëgjimore, pasi kanë mbaruar anëtarët e Këshillit.

Neni 25

Konfidencialiteti, mbrojtja e të dhënave dhe klasifikimi

Procedurat e parashikuara në këtë rregullore kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionin e klasifikuar. Dokumentet duhet të jenë të redaktuara para publikimit, në rast se përmbajnë informacion personal të kandidatëve ose informacion rreth personave të tjerë.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

SHTOJCA A

PLATFORMA DHE VIZIONI I KANDIDATIT/ES PËR PROKURORË TË PËRGJITHSHËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

I. Vizioni, politikat dhe strategjitë në Prokurorinë e Përgjithshme gjatë mandatit.

1. Si e vlerësoni situatën në Prokurorinë e Përgjithshme gjatë katërvjeçarit të fundit (kritikat janë të vlerësueshme).

2. Listoni përparësitë kryesore të Prokurorit të Përgjithshëm dhe arsyet e përzgjedhjes së tyre,

3. Evidentoni mangësitë e Prokurorit të Përgjithshëm (si institucion kushtetues, nëse ka) dhe adresimin e zgjidhjeve.

4. Cilat janë sfidat e Prokurorit të Përgjithshëm gjatë mandatit.

II. Aftësia drejtuese dhe lidhshëmi për të udhëhequr sistemin e Prokurorisë gjatë periudhës së mandatit

1. Cili është misioni dhe vizioni juaj gjatë mandatit,

2. Evidentoni vështirësitë e rolit tuaj, rreziqet dhe masat për kapërcimin e tyre.

III. Aftësitë menaxheriale gjatë periudhës së mandatit

1. Me qëllim përmbushjen e misionit dhe vizionit tuaj në krye të Prokurorisë së Përgjithshme listoni pesë prioritetet kryesore dhe arsyen e përzgjedhjes.

IV. Vizioni për të menaxhuar burimet njerëzore në sistemin e Prokurorisë

Secili kandidat duhet të rendisë hapat që do të ndërmerren gjatë mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm për të përmbushur objektivat kryesore:

1. Hapat që do të ndërmerren gjatë dy viteve të para;

2. Hapat që do të ndërmerren gjatë dyvjeçarit të dytë;

3. Hapat që do të ndërmerren deri në mbarimin e mandatit.

V. Përvoja praktike në sistemin e drejtësisë penale, duke përfshirë edhe çështjet thelbësore të të drejtave të njeriut

1. Evidento përvojën e deritanishme,

2. Hapat të cilët do të ndërmerren për të rritur nivelin e besueshmërisë së publikut në sistemin e prokurorisë

3. Hapat dhe planifikimet që do të kryhen për të evidentuar nëse në sistemin e Prokurorisë respektohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Emri Mbiemri

Nënshkrimi

Data dhe vendi i nënshkrimit _____

SHTOJCA B

AUTORIZIM

Mbi verifikimin e pasurisë

Unë i/e nënshkruari/a (emri, atësia, mbiemri), kandidat/e për Prokuror i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, autorizoj Këshillin e Lartë të Prokurorisë të kryejë verifikimin në të gjitha subjektet publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari time dhe personave të lidhur.

Ky autorizim ka vlerë deri në përfundim të procesit të përzgjedhjes dhe propozimit të



kandidatëve për prokurorë të përgjithshëm, Kuvendit të Shqipërisë.

Të gjitha veprimet për të kryer kontroll dhe për të siguruar të dhëna, të kryera nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë apo persona/subjekte të autorizuar prej tij, i konsideroj sikur janë kryer nga unë vetë.

Ky autorizim nënshkruhet prej meje dhe personave të lidhur.¹

Autorizuesi	Data, vendi i nënshkrimit
Emër, mbiemër, nënshkrim	

Personi i lidhur	Data, vendi i nënshkrimit
(lidhja me autorizuesin)	
Emër, mbiemër, firmë ²	

SHTOJCA C AUTORIZIM

Mbi verifikimin e figurës dhe integritetit

Unë i/e nënshkruari/a (emri, atësia, mbiemri), kandidat/e për Prokuror i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, autorizoj Këshillin e Lartë të Prokurorisë të kryejë verifikimin në të gjitha subjektet publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të figurës dhe integritetit tim, si dhe çdo shkak tjetër përjashtues.

Ky autorizim ka vlerë deri në përfundim të procesit të përzgjedhjes dhe propozimit të kandidatëve për prokurorë të përgjithshëm, Kuvendit të Shqipërisë.

Të gjitha veprimet për të kryer kontroll dhe për të siguruar të dhëna, të kryera nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë apo persona/subjekte të autorizuar prej tij, i konsideroj sikur janë kryer nga unë vetë.

Autorizuesi	Data, vendi i nënshkrimit
Emër, mbiemër, nënshkrim	

¹ Person i lidhur ka kuptimin që buron nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

² Nënshkruhet nga çdo person i lidhur me autorizuesin.



SHTOJCA D

FORMULAR

PËR VLERËSIMIN E KANDIDATIT PËR PROKUROR I PËRGJITHSHËM

Kandidati/ja z./znj. _____

Nr.	Komponentët dhe elementet e vlerësimit	Pikët maksimale	Pikët e akorduara	
			Për çdo element	Për komponentin
1	Vlerësimi profesional	20	X	
	Kohëzgjatja dhe rëndësia/përshtatshmëria e eksperiencës në punë me pozicionin në të cilin konkurron.	1-5		
	Rezultatet e vlerësimeve profesionale ose etike të kandidatëve në pozicionet e mëparshme, nëse ka ose rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën e drejtësisë penale.	1-5		
	Rezultatet e arritura gjatë studimeve të tyre të larta, gjatë trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm në Shkollën e Magjistraturës, si dhe në kurse trajnimi të certifikuar në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë.	1-3		
	Rezultatet e arritura gjatë studimeve pasuniversitare në fushën e së drejtës penale.	1-3		
	Punime akademike, studime shkencore, shkrime dhe ligjërata profesionale, botime, pjesëmarrje në aktivitete shkencore, pjesëmarrje në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional i kandidatit gjatë 5 viteve të fundit në fushën e së drejtës.	1-4		
2	Vlerësimi moral dhe i integritetit	4	X	
	Reputacioni që kandidati gëzon në shoqëri dhe te kolegët, si rezultat i aktivitetit të tij profesional bazuar në cilësitë morale, si: ndershmëria, përpikëria në kryerjen e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve, llogaridhënia.	1-2		
	Reputacioni që kandidati gëzon në shoqëri dhe te kolegët, si rezultat i aktiviteteve të kryera gjatë kohës që nuk ushtron funksionin e tij bazuar në cilësitë morale si besueshmëria, paanshmëria, dinjiteti, aktivitete bamirëse ose kulturore.	1-2		
3	Vlerësimi organizativ dhe drejtues	20	X	
	Cilësia e platformës dhe vizionit që ata paragesin sipas shtojcës B të rregullores.	1-5		
	Aftësitë e provuara në marrjen e vendimeve dhe përgjegjësi, bazuar gjithashtu në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore.	1-5		
	Aftësitë në komunikim	4		
	Aftësia për të punuar në grup dhe në mjedise multidisiplinare dhe/ose multikulturore.	1-3		
	Aftësia për përfaqësim në publik.	1-3		
4	Elemente shtesë për vlerësim	6	X	



	Mbajtja e titujve akademikë (1 pikë për çdo titull deri në 2 pikë totali).	1-2		
	Studime dhe trajnime afatgjata të kryera jashtë vendit jo më pak se dy javë në fushën e së drejtës penale ose menaxheriale (deri në 2 pikë).	1-2		
	Zotërimi i gjuhëve të huaja duke i dhënë përparësi gjuhëve zyrtare të Këshillit të Evropës.	1-2		
	* Për çdo gjuhë të huaj, të cilën kandidati e njeh shumë mirë, vlerësohet me 1 pikë.			
	* Për çdo gjuhë të huaj, të cilën kandidati e njeh në nivel pune, vlerësohet me 0.5 pikë.			
	TOTALI I PIKËVE	50		

Anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë
Emri Mbiemri

SHTOJCA E
VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR I KANDIDATËVE

Nr.	EMRI E MBIEMRI I KANDIDATIT/ES												TOTALI
		VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR SIPAS ANËTARËVE TË KLP-së											
1													
2													
3													
4													
5													
6													
7													
8													
9													
10													



RENDITJA E KANDIDATËVE PËR PROKUROR I PËRGJITHSHËM

Nr.	Emri e mbiemri	Pikë në total
1		
2		
3		
4		
5		
6		
7		
8		
9		
10		
11		
12		
13		
14		
15		

VENDIM

Nr. 51, datë 19.3.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI KRITERET DHE PROCEDURËN PËR NGRITJEN NË DETYRË TË PROKURORËVE PRANË PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR”

Në mbështetje të neneve 148/dh dhe 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 47, 48 dhe 163 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenit 189, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe neneve 2, 7, 12 dhe 57, të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gent Ibrahimi

RREGULLORE

MBI KRITERET DHE PROCEDURËN PËR
NGRITJEN NË DETYRË TË
PROKURORËVE PRANË PROKURORISË SË
POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE
KRIMIT TË ORGANIZUAR

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i rregullores është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për ngritjen në detyrë të prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (Prokuroria e Posaçme), bazuar në një proces objektiv, transparent dhe gjithëpërfshirës, me synim krijimin e Prokurorisë së Posaçme të aftë për të ushtruar funksionet e saj në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe efektive.

Neni 2 Përkufizime

Termat e përdorura në këtë rregullore, kanë këto kuptime:

a) “Ditë” ka kuptimin e ditës kalendarike. Nëse dita e fundit është ditë pushimi, atëherë përfundimi i afatit do të shtyhet në ditën pasardhëse të punës.

b) “Këshilli” është Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

c) “Prokuror i Posaçëm” është prokurori në



Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

ç) “Ngritje në detyrë” nënkupton kalimin nga:

i. një pozicion në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, në një pozicion në Prokurorinë e Posaçme;

ii. një pozicion si prokuror në Prokurorinë e Posaçme, në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

d) “Komision” është Komisioni i Posaçëm me pesë anëtarë për vlerësimin e kandidatëve për prokurorë të Prokurorisë së Posaçme.

dh) “SPAK” është struktura e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar e përbërë nga Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit.

e) “Kandidat” është prokurori i cili shpreh interesin për të plotësuar një pozicion vakant në Prokurorinë e Posaçme ose që kërkon të zgjidhet Drejtues i saj.

ë) “Me kualifikim të lartë” kuptohet vlerësimi maksimal i akorduar për kandidatin sipas pikëzimit të parashikuar në nenin 8 të kësaj rregulloreje.

f) “Me kualifikim të mesëm” kuptohet vlerësimi mesatar i akorduar për kandidatin sipas pikëzimit të parashikuar në nenin 8 të kësaj rregulloreje.

g) “Me kualifikim të ulët” kuptohet vlerësimi minimal i akorduar për kandidatin sipas pikëzimit të parashikuar në nenin 8 të kësaj rregulloreje.

gj) “Institucionet e rivlerësimit” janë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Apelimit.

h) “Konfirmuar pas rivlerësimit” konsiderohet:

i. kandidati i konfirmuar në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, vendimi për të cilin nuk është ankimuar brenda afatit ligjor; ose

ii. pas ankimit, kandidati i konfirmuar në detyrë nga Kolegji i Apelimit.

i) “Ekspert” është prokurori që ka nivel të lartë të njohurive ose përvojës, të njohur nga një institucion publik, në lidhje me kriteret e posaçme etike e morale të parashikuara në nenin 9 të kësaj rregulloreje, për shkak të angazhimit në mësimdhënie, në hartimin e legjislacionit, të pjesëmarrjes në komitetet e ekspertëve pranë organizatave vendase dhe ndërkombëtare, në trajnime afatgjata ose botime në fusha që lidhen me objektin e veprimtarisë së Prokurorisë së Posaçme të parashikuar nga ligji procedural penal.

j) “Teknikat e posaçme të hetimit” janë metodat speciale të hetimit sipas Kodit të Procedurës Penale

dhe parashikimeve të tjera ligjore, përdorimi i të cilave nuk është i autorizuar për të gjitha llojet e veprave penale, të tilla si veprimet simuluese, infiltrimi në përbërje të grupit kriminal, dorëzimi i kontrolluar, mbrojtja e dëshmitarit, si dhe teknika të tjera si vendimet për kontroll në rastet e hetimeve të veprave penale të korrupsionit, sigurimi me anë të letërporosisë i provave që gjenden jashtë vendit, sigurimi i provave kompjuterike, përdorimi i provave mjekoligjore, si: ADN, përdorimi i ekspertizës kontabël, përgjimi elektronik, marrja dhe përdorimi i informacioneve nga vende të huaja, provat kompjuterike, përdorimi i bashkëpunëtorëve të drejtësisë ose bashkëpunimi në marrëveshjet e fajësisë etj.

k) “Çështje të ndërlikuara ligjorisht dhe në fakte” konsiderohen ato çështje ku subjekt i hetimit është një funksionar i lartë publik, të cilat kanë një numër të madh të pandehurish ose një numër të madh veprash penale, që passjellin pasoja të rënda për jetën dhe pasurinë e personave ose shkaktojnë dëm të madh ekonomik, të cilat rezultojnë në konfiskimin e aseteve me vlera të mëdha etj.

l) “Hetim proaktiv” është ai hetim ku procesi i mbledhjes së provave kryhet njëkohësisht me lindjen e dyshimit për kryerjen e veprës së dyshuar penale, si dhe hetimet që nisen nga prokurori në mungesë të një kallëzimi ose çdo hetim i cili është dukshëm më i zgjeruar se kallëzimi origjinal.

ll) “Hetim i suksesshëm” është çdo procedim i dërguar për gjykim në përfundim të të cilit është marrë fajësi ose kur prokurori tregon se veprimet hetimore kanë qenë shteruese pavarësisht vendimit të gjykatës.

m) “Kërkesë e suksesshme për konfiskim” konsiderohet çdo kërkesë e prokurorit e pranuar nga gjykata, ose kur, ndonëse kërkesa nuk është pranuar nga gjykata, vlerësohet se veprimet e kryera nga prokurori kanë qenë shteruese dhe të sakta.

n) Ligji “antimafia” është ligji nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Neni 3

Rregulla të përgjithshme për ngritjen në detyrë si prokuror i posaçëm

1. Komisioni kryen një vlerësim fillestar të të gjithë kandidatëve për të përcaktuar nëse ata i



plotësojnë kushtet ligjore për ngritjen në detyrë si prokurorë të posaçëm.

2. Komisioni i propozon Këshillit skualifikimin e kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet ligjore.

3. Këshilli skualifikon çdo kandidat i cili nuk plotëson kushtet ligjore dhe shpall listën zyrtare të kandidatëve që vijojnë procesin e vlerësimit.

4. Pas vendimit për shpalljen e listës zyrtare të kandidatëve, Këshilli i përcjell organeve të rivlerësimit emrat e kandidatëve të cilët nuk i janë nënshtruar ende procesit të rivlerësimit.

5. Komisioni vijon me vlerësimin e kandidatëve. Komisioni kërkon nga institucionet publike çdo lloj dokumenti të rëndësishëm për vlerësimin. Këshilli kryen intervistat me kandidatët.

6. Komisioni përdor dokumentet dhe letrat e motivimit për të bërë propozimet përkatëse për vlerësimin e kandidatëve për pozicionin e prokurorit të posaçëm, bazuar në:

- i. vlerësimet e mëparshme profesionale; dhe
- ii. kriteret e posaçme etike dhe profesionale të parashikuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje.

7. Në çdo rast, për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve, përveç propozimit të Komisionit, Këshilli merr parasysh edhe angazhimin personal dhe profesional të kandidatit si ekspert, si dhe intervistat e kandidatëve.

8. Në rast se pas vlerësimit të kriterëve të posaçme etike dhe profesionale, ka kandidatë me pikë të barabarta Këshilli i rendit kandidatët sipas vjetërsisë si magjistrat ose jurist.

9. Komisioni propozon për secilin kandidat dhe për secilin nga kriteret e parashikuara në nenin 7, njërën nga shkallët e vlerësimit të parashikuar në nenin 8 të kësaj rregulloreje.

10. Këshilli bën vlerësimin përfundimtar të kandidatëve dhe renditjen e tyre sipas nenit 16. Vlerësimi dhe renditja e kandidatëve miratohet me shumicën e votave të Këshillit.

11. Këshilli vendos ngritjen në detyrë të kandidatëve pasi ata të kenë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit.

12. Krijimi i Prokurorisë së Posaçme shpallet me vendim të Këshillit.

13. Menjëherë pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, Këshilli fton prokurorët e kësaj prokurorie që të shprehin interesin për pozicionin e kryetarit.

14. Në rast konflikti ndërmjet këtij neni dhe neneve të cilat parashikojnë rregullime të posaçme për secilin hap të procedurës, neni me parashikime të posaçme ka përparësi.

KREU II

KUSHTET LIGJORE DHE KRITERET E VLERËSIMIT

Neni 4

Kushtet ligjore për ngritjen në detyrë si prokuror i posaçëm

Kushtet ligjore që duhet të përmbushë prokurori që kandidon për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme, janë:

1. Të jetë prokuror i Republikës së Shqipërisë dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

2. Të ketë ushtruar funksionin si prokuror për jo më pak se 10 (dhjetë) vjet, duke përfshirë edhe përvojën si prokuror i komanduar.

3. Të përmbushë kushtet e sigurisë, të parashikuara në nenin 6, të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, përfshirë edhe kushtin se duhet të ketë dorëzuar formularë të vlefshëm të shprehjes së pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe telekomunikimeve personale, të nënshkruar prej kandidatit dhe anëtarëve të afërt të familjes.

4. Të ketë kaluar me vendim të formës së prerë procesin e rivlerësimit.

Neni 5

Kriteri i vlerësimit të performancës

Kriteri i vlerësimit të performancës të kandidatëve përfshin dy vlerësimet e fundit të performancës së kandidatit.

Neni 6

Shkallët e vlerësimit të kriterit të performancës

Shkallët e vlerësimit të kriterit të performancës së kandidatit, bazuar në rezultatet e tyre në dy vlerësimet e fundit profesionale të parashikuara në nenin 5, janë si më poshtë:

a) pesë pikë për kandidatët që janë vlerësuar “Shumë mirë” në dy vlerësimet e fundit të performancës;



b) katër pikë për kandidatët që janë vlerësuar “Shumë mirë” dhe “Mirë” në dy vlerësimet e fundit të performancës;

c) tri pikë për kandidatët që janë vlerësuar “mirë” në dy vlerësimet e fundit të performancës;

ç) dy pikë për kandidatët që janë vlerësuar “mirë” dhe “mjaftueshëm” në dy vlerësimet e fundit të performancës;

d) një pikë për kandidatët që janë vlerësuar “mjaftueshëm” në dy vlerësimet e fundit të performancës.

Neni 7

Kriteret e posaçme etike dhe profesionale për ngritjen në detyrë si Prokuror i Posaçëm

1. Kriteret e posaçme etike dhe profesionale për ngritjen në detyrë si Prokuror i Posaçëm janë:

a) Aftësitë e treguara: në hetim, përfshirë përdorimin e teknikave të posaçme të hetimit dhe qasjen proaktive të hetimi; në ndjekjen penale, përfshirë formulimin e akuzës dhe përfaqësimin në gjykatë; dhe në konfiskimin e produkteve të veprës penale dhe të aseteve, sipas Kodit të Procedurës Penale ose ligjit antimafia; dhe

b) Vendosmëria e treguar në përballimin e vështirësive, presioneve e rreziqeve dhe integriteti i posaçëm profesional, përfshi etikën profesionale, ndershmërinë, paanësinë, sigurinë dhe konfidencialitetin e treguar nga kandidati.

Neni 8

Shkallët e vlerësimit të kriterëve të posaçme etike dhe profesionale

Shkallët e vlerësimit për kriteret etike e profesionale të parashikuara në nenin 7 janë:

a) “Kualifikim i lartë”, i cili vlerësohet me 8 - 10 pikë;

b) “Kualifikim i mesëm” i cili vlerësohet me 4 - 7 pikë;

c) “Kualifikimi i ulët” i cili vlerësohet me 1 - 3 pikë.

Neni 9

Aftësitë e treguara në hetim, në ndjekjen penale dhe në konfiskim

1. Kandidati vlerësohet me “Kualifikim të lartë” për këtë kriter kur verifikohet një nga faktet e mëposhtme:

a) ka hetuar me sukses jo më pak se pesë çështje penale të ndërlikuara ligjërish ose në fakte, përfshi përdorimin e metodave të avancuara të hetimit dhe qasjen proaktive;

b) ka qenë drejtues grupi hetimor ose prokuror i vetëm dhe/ose ka përfaqësuar prokurorinë në nivel apeli/Gjykatë të Lartë, në jo më pak se pesë procese gjyqësore për të cilat është dhënë vendim dënimi për korrupsion, krim të organizuar, pastrim parash ose për çështje të tjera të ndërlikuara;

c) ka qenë pjesë e një grupi prokurorësh, në shkallë të parë ose në nivel apeli, në jo më pak se dhjetë procese gjyqësore, në të cilat është dhënë vendim dënimi për korrupsion, krim të organizuar, pastrim parash, ose për çështje të tjera të ndërlikuara;

ç) ka kërkuar me sukses konfiskimin e pasurive të cilat janë produkte të veprës penale në jo më pak se pesë raste dhe/ose kur vlera e aseteve të konfiskuara ka qenë e lartë ose ka kërkuar me sukses konfiskimin e pasurive në zbatim të ligjit antimafia në jo më pak se pesë raste dhe/ose kur vlera e aseteve të konfiskuara ka qenë e lartë.

2. Kandidati vlerësohet me “Kualifikim të mesëm” për këtë kriter kur verifikohet një nga faktet e mëposhtme:

a) ka hetuar me sukses jo më pak se tri çështje penale të ndërlikuara ligjërish ose në fakte përfshi përdorimin e metodave të avancuara të hetimit dhe qasjen proaktive;

b) ka qenë drejtues grupi hetimor ose prokuror i vetëm dhe/ose ka përfaqësuar prokurorinë në nivel apeli / Gjykatë të Lartë, në jo më pak se pesë procese gjyqësore në të cilat është dhënë vendim dënimi për korrupsion, krim të organizuar, pastrim parash ose për çështje të tjera të ndërlikuara;

c) ka qenë pjesë e një grupi prokurorësh, në shkallë të parë ose në nivel apeli, në jo më pak se dhjetë procese gjyqësore, në të cilat është dhënë vendim dënimi për korrupsion, krim të organizuar, pastrim parash, ose për çështje të tjera të ndërlikuara;

ç) ka kërkuar me sukses konfiskimin e pasurive që përbëjnë produkte të veprave penale në jo më pak se pesë raste dhe/ose kur vlera e aseteve të konfiskuara ka qenë mesatare ose ka kërkuar me sukses konfiskimin e pasurive në



zbatim të ligjit antimafia, në më pak se pesë raste dhe/ose kur vlera e aseteve të konfiskuara ka qenë mesatare.

3. Kandidati vlerësohet me “Kualifikim të ulët” për këtë kriter kur verifikohet një nga faktet e mëposhtme:

a) ka hetuar me sukses të paktën 1 çështje penale të ndërlikuar ligjërisht ose në fakte, përfshi përdorimin e metodave të avancuara të hetimit dhe qasjen proaktive ose është përpjekur të hetojë çështje të ndërlikuara dhe të përdorë teknika të avancuara hetimi, por ka qenë i pasuksesshëm;

b) nuk ka marrë pjesë në procese gjyqësore në të cilat është dhënë vendim për korrupsion, krim të organizuar, pastrim parash, ose çështje të tjera penale të ndërlikuara;

c) ka ndihmuar në të paktën një rast, një prokuror tjetër, i cili ka kërkuar me sukses konfiskimin e pasurive që përbëjnë produkte të veprave penale dhe/ose kur vlera e aseteve të konfiskuara ka qenë e ulët ose ka ndihmuar në të paktën një rast, një prokuror tjetër, i cili ka kërkuar me sukses konfiskimin e pasurive në zbatim të ligjit antimafia, dhe/ose kur vlera e aseteve të konfiskuara ka qenë e ulët.

4. Komisioni shqyrton aktet procedurale të kandidatit në çështjet në fjalë dhe aktet respektive të gjykatës, për të përcaktuar nëse produkti i punës së tij/saj është ligjërisht i plotë, i saktë në fakte, i organizuar dhe paraqitur mirë. Komisioni vlerëson në mënyrë të posaçme ato tipare të punës së kandidatëve që janë thelbësore dhe të lidhura me aftësitë e treguara në hetim, përdorimin e teknikave të posaçme, ndjekjen penale, përfaqësimin në gjykatë dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale sipas Kodit të Procedurës Penale dhe të aseteve sipas ligjit antimafia.

5. Për të vlerësuar sa më mirë aftësitë e treguara sipas këtij neni, Komisioni shqyrton gjithashtu edhe çdo çështje tjetër të hetuar nga kandidati gjatë karrierës së tij e cila ka tërhequr vëmendjen e opinionit publik.

Neni 10

Vendosmëria e treguar në përballimin e vështirësive, presioneve e rreziqeve dhe integriteti

1. Kandidatët i paraqesin Komisionit situatat/rrethanat ku ata kanë kapërcyer vështirësi të spikatura ose i kanë bërë ballë presionit gjatë një hetimi ose ndjekjeje penale, duke bërë të mundur dërgimin e çështjes në gjyq. Kandidati përshkruan qartë vështirësitë dhe veprimet e kryera prej tij që kanë kontribuar në suksesin e hetimit ose ndjekjes penale.

2. Kandidatët i paraqesin Komisionit situatat/rrethanat ku ata kanë treguar etikë të lartë profesionale duke ruajtur paanësinë, ndershmërinë dhe konfidencialitetin e të dhënave hetimore pavarësisht vështirësive të spikatura me të cilat janë përballur.

3. Komisioni i vlerëson kandidatët me “Kualifikim të lartë”, “Kualifikim të mesëm” ose “Kualifikim të ulët” në varësi të sasisë dhe cilësisë së situatave/rrethanave që kanë vënë në provë vendosmërinë dhe integritetin e kandidatit.

4. Komisioni shqyrton aktet procedurale të kandidatit dhe aktet respektive të gjykatës për të vërtetuar vendosmërinë dhe integritetin e kandidatit. Komisioni vlerëson në mënyrë të posaçme ato tipare të punës së kandidatëve që janë thelbësore dhe të lidhura me vendosmërinë e treguar në përballimin e vështirësive, presioneve e rreziqeve.

KREU III

PROCESI I VLERËSIMIT

Neni 11

Komisioni i Posaçëm

1. Për vlerësimin paraprak të kandidatëve për prokuror në Prokurorinë e Posaçme, Këshilli krijon një Komision të Posaçëm;

2. Komisioni i Posaçëm përbëhet nga 5 anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, prej të cilëve 3 anëtarë prokurorë dhe 2 anëtarë joprokurorë. Anëtarët e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës janë *ex officio* anëtarë të Komisionit të Posaçëm. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale përjashtohen *ex officio* nga pjesëmarrja në Komisionin e Posaçëm. Dy anëtarët e tjerë të Komisionit të Posaçëm, njëri prej të cilëve anëtar



prokuror dhe tjetri anëtar jo prokuror, zgjidhen me short nga pjesa e mbetur e anëtarëve të Këshillit.

3. Kryetari i Këshillit cakton kryetarin e Komisionit të Posaçëm;

4. Kryetari i Komisioni të Posaçëm relaton para Këshillit rezultatet e vlerësimit paraparak të kandidatëve;

5. Veprimtaria e Komisionit mbaron me krijimin e Prokurorisë së Posaçme.

Neni 12

Shqyrtimi fillestar

1. Brenda 7 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, Komisioni fillon verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për ngritjen në detyrë.

2. Kryetari i Komisionit raporton në mbledhjen e radhës së Këshillit, e cila mbahet sa më shpejt të jetë e mundur, emrat e kandidatëve të cilët vlerësohet se nuk përmbushin kushtet ligjore. Këshilli miraton listën me emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore sipas rendit alfabetik.

3. Komisioni verifikon statusin e kandidatit në procesin e rivlerësimit kalimtar të kandidatit sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Apelimit.

4. Këshilli i përcjell Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për rivlerësim me përparësi, emrat e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet ligjore dhe nuk i janë nënshtruar ende procesit të rivlerësimit, si dhe Komisionit të Posaçëm të Apelimit emrat e kandidatëve për të cilët, në kuadër të procesit të rivlerësimit, është ushtruar ankimi pranë këtij institucioni duke kërkuar kryerjen/përfundimin me përparësi të procesit të rivlerësimit.

Neni 13

Procesi i vlerësimit në Komision

1. Pasi Këshilli përcakton kandidatët që përmbushin kushtet ligjore sipas nenit 4, Komisioni i vlerëson ata sipas kriterëve të parashikuara në nenet 5 dhe 7 të kësaj rregulloreje dhe sipas shkallëve të vlerësimit të parashikuara në nenet 6 dhe 8 të kësaj rregulloreje.

2. Anëtarët e Komisionit shqyrtojnë të gjitha dokumentet e kandidatit dhe standardet e renditura në nenet 5–10. Këto standarde përfshijnë aplikimin e kandidatit, vlerësimet e mëparshme të kandidatit, produktet e mëparshme të punës, deklaratat e motivimit ose dokumente të tjera të bashkëngjitura.

3. Komisioni vendos shkallën e vlerësimit të secilit kriter për secilin kandidat me shumicë të thjeshtë dhe ia propozon Këshillit sipas shtojcës A të kësaj rregulloreje. Anëtarët/anëtarët e mbetur në pakicë në Komision mund t'i propozojnë dhe argumentojnë Këshillit një shkallë të ndryshme vlerësimi.

4. Anëtarët e Komisionit arsyetojnë për shkallën e propozuar të vlerësimit dhe përshkruajnë faktet mbi të cilat mbështesin arsyetimin. Propozimit i bashkëlidhen të gjitha dokumentet mbështetëse.

Neni 14

Afatet lidhur me procedurën e vlerësimit

1. Komisioni kërkon nga kandidatët të identifikojnë produktin e punës së tyre dhe çështjet që mbështesin aplikimin e tyre, në përputhje me kriteret e renditura në nenin 9. Kandidatët kanë 7 ditë afat kohor për të identifikuar këto dokumente dhe për t'i vënë në dispozicion të Komisionit.

2. Komisioni përfundon vlerësimin e kandidatëve sipas shkallëve të përcaktuara në nenin 8 të kësaj rregulloreje brenda 6 javëve nga mbledhja e parë sipas nenit 12 dhe i dërgon Këshillit raportin përfundimtar.

3. Këshilli realizon intervistat me kandidatët brenda 2 javëve nga dërgimi i raportit të Komisionit. Intervistat me kandidatët regjistrohen me audio dhe video. Këshilli mund të kërkojë prej kandidatëve ose institucioneve publike informacione shtesë të cilat e ndihmojnë në vlerësimin e kandidatit.

4. Këshilli bën vlerësimin përfundimtar dhe renditjen e kandidatëve jo më vonë se 1 javë nga përfundimi i procesit të intervistimit të kandidatëve.

Neni 15

Raportimi në Këshill

Kur Komisioni përfundon vlerësimet e tij, kryetari i Komisionit njofton kryetarin e



Këshillit, i cili thërret mbledhjen plenare të Këshillit. Kryetari i Komisionit vendos në dispozicion të anëtarëve të Këshillit kopje të vlerësimeve të shkruara dhe dokumentet mbështetëse. Gjatë mbledhjes së hapur, kryetari i Komisionit prezanton për anëtarët një përmbledhje të rezultateve të vlerësimit.

Neni 16

Vlerësimi në Këshill

1. Këshilli, bazuar në propozimin e Komisionit, vendos shkallën e vlerësimit për secilin kandidat dhe për secilin kriter.

2. Këshilli mund të ndryshojë shkallën e vlerësimit të propozuar nga Komisioni me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm;

3. Pasi vendoset shkalla e vlerësimit për secilin kandidat, çdo anëtar i Këshillit vendos pikët për secilin prej kriterëve, brenda hapësirës së pikëzimit të caktuar për atë shkallë vlerësimi në nenin 8, duke plotësuar tabelën në shtojcën B të kësaj rregulloreje.

4. Në përfundim të procesit të pikëzimit, kandidatët renditen sipas numrit të pikëve në përputhje me tabelën në shtojcën C të kësaj rregulloreje.

KREU IV

KRIJIMI DHE DREJTIMI I PROKURORISË SË POSAÇME

Neni 17

Krijimi i Prokurorisë së Posaçme

1. Këshilli mblidhet për të vendosur krijimin e Prokurorisë së Posaçme sapo të arrihet numri i nevojshëm i prokurorëve të konfirmuar për ngritje në detyrë si prokuror të posaçëm, të cilët kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit.

2. Këshilli koordinon punën me Këshillin e Lartë Gjyqësor për të siguruar lehtësi në krijimin e Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokurorisë së Posaçme.

3. Pasi Prokuroria e Posaçme të jetë krijuar, dhe kur prokurorë të tjerë, të konfirmuar për ngritje në detyrë të kenë marrë konfirmimin nga procesi i rivlerësimit, Këshilli mblidhet sa më shpejt të jetë e mundur.

4. Nëse një kandidat nuk kalon me sukses procesin e rivlerësimit, ai/ajo nuk kualifikohet për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme.

Faqe | 3628

5. Pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, Këshilli mund të rihapë thirrjen për aplikime në rast se ka nevojë për më tepër anëtarë.

Neni 18

Zgjedhja e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme

1. Pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, Komisioni i kërkon me shkrim prokurorëve të ngritur në detyrë, që të shfaqin interesin për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Kandidatët e interesuar paraqesin motivimin e tyre, sipas standardeve të parashikuara në nenin 19, brenda 5 ditëve nga kërkesa e Komisionit. Letra e motivimit për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme nuk duhet të jetë më tepër se 5 faqe, të shkruara me shkrim 12, në llojin Times New Roman.

2. Këshilli zgjedh drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme në mbledhjen e tij më të afërt.

Neni 19

Standardet e vlerësimit për zgjedhjen e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme

Në përzgjedhjen e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, Këshilli vlerëson:

a) eksperiencën në ndjekjen e çështjeve sensitive të korrupsionit dhe krimi të organizuar;

b) eksperiencën dhe aftësitë në organizimin dhe drejtimin e një strukture;

c) eksperiencën në hartimin e miratimin e rregulloreve administrative;

ç) eksperiencën në çështje të cilat kanë marrë vëmendje të lartë publike dhe ndërveprim me median;

d) aftësitë në drejtimin efektiv të burimeve njerëzore;

dh) vizionin ose planin e besueshëm për ndërtimin e Prokurorisë së Posaçme, si një institucion funksional dhe efektiv;

e) imazhin publik të karrierës së tij/saj si prokuror.

Neni 20

Procedura e zgjedhjes së drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme

1. Këshilli fton çdo prokuror të Prokurorisë së Posaçme, që ka dorëzuar letrën e motivimit për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, për të trajtuar para Këshillit në një



prezantim të shkurtër secilin prej standardeve të renditura në nenin 19.

2. Votimi për drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme bëhet i hapur dhe nominal.

3. Secili anëtar i Këshillit nuk mund të votojë për më shumë se një kandidat për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

4. Drejtues i Prokurorisë së Posaçme zgjidhet kandidati që merr më shumë vota në Këshill.

5. Në rast se dy a më shumë kandidatë marrin numër të barabartë votash, Këshilli kryen një votim të dytë mes kandidatëve me numër të barabartë votash.

6. Nëse asnjëri prej prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme nuk shfaq interes për pozicionin e drejtuesit Këshilli cakton përkohësisht në këtë detyrë njërin nga prokurorët.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 21 Konflikti i interesave

1. Anëtari i Komisionit ose i Këshillit, që ka pengesa ligjore në kuptim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe ka konflikt interesi në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, heq dorë nga detyrat e tij/saj në procesin e vlerësimit, renditjes dhe votimit të kandidatëve.

2. Në këtë rast, detyrat e anëtarit të Komisionit ushtrohen nga anëtari zëvendësues.

3. Në rast se një anëtar i Komisionit heq dorë, anëtari zëvendësues zgjidhet me short për të qenë pjesë e procesit të vlerësimit të kandidatit.

Neni 22

Komunikimet jozyrtare gjatë procesit të zgjedhjes

1. Ndalohen komunikimet jozyrtare mes një anëtari të Komisionit/Këshillit dhe një kandidati për prokuror në Prokurorinë e Posaçme duke filluar nga data e miratimit të kësaj rregulloreje deri në ditën e shpalljes së rezultateve.

Neni 23

Monitoruesit e procesit të vlerësimit

Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe OPDAT mund të jenë pjesëmarrës në procesin e intervistave dhe faza të tjera të vlerësimit të kandidatëve. Monitoruesit ndërkombëtarë mund të drejtojnë pyetje gjatë intervistave, pasi të kenë përfunduar anëtarët e Këshillit.

Neni 24

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave

1. Procedurat e parashikuara në këtë rregullore kryhen në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionin e klasifikuar.

2. Dokumentet duhet të jenë të redaktuara para publikimit, në rast se përmbajnë informacion personal të kandidatëve ose informacion rreth personave të tjerë.

Neni 25

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.



SHTOJCA A
VLERËSIMI INDIVIDUAL NGA KOMISIONI SIPAS SHKALLËVE, TË
KANDIDATËVE PËR PROKURORINË E POSAÇME

Formulari nr. 1

Nr.	Emri e mbiemri i kandidatit	KOMPONENTËT E VLERËSIMIT TË AFTËSIVE SIPAS SHKALLËVE					
		Ndjekja penale, hetimi, teknikat, përfaqësimi, konfiskimi			Vendosmëria dhe integriteti		
		i ulët	i mesëm	i lartë	i ulët	i mesëm	i lartë
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							
8							
9							
10							
11							
12							
13							
14							
15							
16							
17							
18							
19							
20							
21							
22							
23							
24							
25							
26							
27							

KOMISIONI I POSAÇËM

(_____)



VLERËSIMI I PERFORMANCËS

Formulari nr. 2

Nr.	Emri e mbiemri i kandidatit	Viti paraardhës			Viti i fundit			TOTALI
		Mjaftueshëm 0.5 pikë	Mirë 1.5 pikë	Shumë mirë 2.5 pikë	Mjaftueshëm 0.5 pikë	Mirë 1.5 pikë	Shumë mirë 2.5 pikë	
1								
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								
11								
12								
13								
14								
15								
16								
17								
18								
19								
20								
21								
22								
23								
24								
25								
26								
27								

KOMISIONI I POSAÇËM



SHTOJCA B
VLERËSIMI INDIVIDUAL, SIPAS KOMPONENTËVE TË KANDIDATËVE PËR
PROKURORINË E POSAÇME

Formulari nr. 3

Nr.	Emri e mbiemri i kandidatit	KOMPONENTËT E VLERËSIMIT TË AFTËSIVE SIPAS SHKALLËVE						TOTALI
		Ndjekja penale, hetimi, teknikat, përfaqësimi, konfiskimi			Vendosmëria dhe integriteti			
		i ulët 1–3	i mesëm 4–7	i lartë 8–10	i ulët 1–3	i mesëm 4–7	i lartë 8–10	
1								
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								
11								
12								
13								
14								
15								
16								
17								
18								
19								
20								
21								
22								
23								
24								
25								
26								
27								

ANËTAR I KËSHILLIT TË LARTË TË
PROKURORISË



SHTOJCA C

Në	Emri e mbiemri i kandidatit	VLERËSIMI ME PIKË SIPAS ANËTARËVE TË KËSHILLIT											Vlerës. performanc.	TOTALI
1														
2														
3														
4														
5														
6														
7														
8														
9														
10														
11														
12														
13														
14														
15														
16														
17														
18														
19														
20														
21														
22														
23														
24														
25														
26														
27														

**RENDITJA E KANDIDATËVE
PËR PROKURORINË E POSAÇME****Formulari nr. 5**

Nr.	Emri e mbiemri i kandidatit	Pikë në total
1		
2		
3		
4		
5		
6		
7		
8		
9		
10		
11		
12		
13		
14		
15		
16		
17		
18		
19		
20		
21		
22		
23		
24		
25		
26		
27		

**KËRKESË****Nr. 3484/7, datë 21.3.2019****PËR SHPRONËSIM**

Ministria e Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës së fshatit Muçaj (Unaza), Bashkia Vorë”.

Subjekti kërkuar është Bashkia Vorë. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së

shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është 252 672 (dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I BRENDSHËM
Romina Kuko

LISTA E PRONAVE DHE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT
“RIKONSTRUKSION I RRUGËS SË FSHATIT MUÇAJ (UNAZA) BASHKIA VORË”

Nr.	Emri / mbiemri (pronari që shpronësohet)	Zona kadastrale	Lloji i pasurisë	Numri i pasurisë	Sipërfaqja e prekur/m ²	Çmimi i tokës bujqësore/ lekë/m ²	Vlera e përgjithshme e shpronësimit	Shënime
1	Xhaferr Hariz Muça	2726-Muçaj	tokë bujqësore	18/44	400	448	179,200	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Dylaver Hysen Shpati	2726-Muçaj	tokë bujqësore	45/5	100	448	44,800	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Kolec Geg Biba	2726-Muçaj	tokë bujqësore	45/3	64	448	28,672	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	SHUMA				564		252,672	

KËRKESË**Nr. 4606/5, datë 21.3.2019****PËR SHPRONËSIM**

Ministria e Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës Marqinet-1 dhe lagjja ‘Llanaj’, Bashkia Vorë”.

Subjekti kërkuar është Bashkia Vorë. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së

shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është 322 201 (treqind e njëzet e dy mijë e dyqind e një) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I BRENDSHËM
Romina Kuko



LISTA E PRONAVE DHE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT:
“RIKONSTRUKSION DHE ASFALTIM I RRUGËS MARQINET-1 DHE LAGJJA “LLANAJ”, BASHKIA VORË

Nr.	Emri / mbiemri (pronari që shpronësohet)	Zona kadastrale	Lloji i pasurisë	Nr. kada- stral	Sipërfaqja që shpronësohet /m ²	Çmimi i tokës bujqësore / lekë/m ²	Vlera e përgjithshme e shpronësimit	Shënime
1	Rexhep Islam Ismaili	2605	tokë bujqësore	310/5	465	448	208,320	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Fadil Ymer Ismaili	2605	tokë bujqësore	308/6	73.2	448	32,793	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Ismail Ramazan Ismaili	2605	tokë bujqësore	311/4 5	181	448	81,088	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Shuma				719.2		322,201	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 336 lekë